

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6034  
E enjte, 11 qershor 2020  
çmimi 0.40 €

Lajçaku në javën e ardhshme fillon vrullshëm misionin negociator **FAQE 4-5**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

QEVERIA KA PREZANTUAR, NË AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS, KORNIZËN PËR DIALOGUN ME SERBINË **FAQE 4-5**

## HOTI: DIALOGUN ME SERBINË E UDHËHEQ KRYEMINISTRI



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë të qartë të mërkurën se dialogun me Serbinë do ta udhëheqë ai. Në prezantimin e kornizës së qeverisë për dialogun me Serbinë para

akademikëve, Hoti ka thënë se për këtë çështje nuk do të bëjë garë me bartësit e tjerë institucionalë sepse drejtimin e këtij procesi ia garanton Kushtetuta. Kryeministri Hoti ka bërë me dije se ky

proces do të jetë me parime dhe objektiva të qarta. Ndërsa akademikët e Kosovës kanë kërkuar që institucionet të arrijnë një konsensus nacional për dialogun me Serbinë



## VESELI: DO T'I LARGOJMË QEVERTË E MASHTRIMIT

Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka shpalosur të mërkurën në Prizren vizionin e ri të kësaj partie. Pas mbledhjes së Kryesisë së PDK-së, të mbajtur në këtë qytet, ai ka thënë se misioni i ri i kësaj partie ka për qëllim

t'i largojë nga pushteti qeveritë e mashtimit dhe ta kthejë PDK-në në krye të shtetit. Ai ka thënë se kjo është platforma e ideologjisë djathtiste që mbron vlerat tradicionale, ruan miqësitë dhe zhvillon lirinë **FAQE 3**

## MACRONI THOTË SE DIALOGU KOSOVË - SERBI MUND TË RIFILLOJË NË PARIS **FAQE 7**



### AKTUALE



**TRUMPI KONFIRMON ANGAZHIMIN E FORCAVE AMERIKANE NË KOSOVË F. 2**

**KRYETARËT E KOMUNAVE DISKUTOJNË PËR MASAT DHE PËR PARANDALIMIN E PANDEMISË F. 6**

**SHKON NË 1 298 NUMRI I TË INFektUARVE ME COVID-19 NË KOSOVË F. 3**

**NDËRROI JETË NËNA E HEROIT FEHMI LLADROVCI F. 6**



### EKONOMI

**NGREHËN ÇMIMI I BUKËS, I PEMËVE, I VESHJEVE DHE I PAJISJEVE SHTËPIAKE F. 9**

**ANULOHEN FLUTURIMET E PARAPARA NGA AEROPORTI I PRISHTINËS F. 8**

### SPORT

**UEFA CHAMPIONS LEAGUE 2021-2024, EKSKLUZIVISHT NË "ARTMOTION" F. 18**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Trumpi konfirmon angazhimin e forcave amerikane në Kosovë



PRISHTINË, 10 QERSHOR - Presidenti amerikan, Donald Trump, ka njoftuar kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi dhe presidentin e përkohshëm të Senatit, Chuck Grassley, se forcat e Shteteve të Bashkuara do ta vazhdojnë misionin e tyre në Kosovë. Përmes një letre drejtuar këtyre dy zyrtarëve, Trump ka thënë se: "Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të kontribuojnë në forcat e KFOR-it, të udhëhequra nga NATO-ja, në bashkëpunim me autoritetet lokale, partnerët bilateralë dhe institucionet ndërkombëtare, për ta penguar ripërtirjen e armiqësive në Kosovë". Ai ka përmendur se aktualisht në kuadër të misionit të KFOR-it janë të angazhuar 640 ushtarë amerikanë, nga 4 000

persona sa janë në total. Në mars të këtij viti, dy senatorë amerikanë, David Perdue dhe Rand Paul, patën thënë se ShBA-ja duhet ta rishqyrtojë praninë e saj në Kosovë nëse Kosova nuk e shfuqizon tarifën 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë. Kjo masë, e zëvendësuar fillimisht me reciprocitet, është pezulluar krejtësisht nga kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, për shkak të, siç është shprehur ai, heqjes së të gjitha pengesave për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Ky dialog është pezulluar nga nëntori i vitit 2018, kur autoritetet e Kosovës patën vendosur taksën. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011 në Bruksel.

## OKB-ja shpalos ndikimin e Covid-19 në shoqërinë e Kosovës

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Ekipi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka prezantuar të mërkurën gjetjet e një hulumtimi të kryer në territorin e Kosovës, në periudhën mars-prill, për t'i kuptuar efektet e koronavirusit në shoqëri. Hulumtimi, i kryer nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), në bashkëpunim me Agjencinë për Gratë të kësaj Organizate, ka gjetur se 56 për qind e personave të anketuar mendojnë se ka pasur rritje të dhunës në familje gjatë asaj periudhe, ndërsa 35 për qind ka thënë se nuk dinë ku të kërkojnë ndihmë nëse vetë ata ose ndokush tjetër përballet me diçka të tillë. Përveç kësaj, 59 për qind e të

anketuarve kanë thënë se kanë pasur frikë që nëse situata e izolimit do të vazhdonte ende, ata do të kishin vështirësi në mbulimin e shpenzimeve bazë. Sipas hulumtimit, 28 për qind e të gjithë të anketuarve janë përballur me ndryshime në shëndetin e tyre psikologjik, mental ose emocional. Sa i përket ruajtjes së vendit të punës, rreth 40 për qind e të anketuarve, që kanë qenë të punësuar para pandemisë, kanë qenë në gjendje ta mbajnë vendin e tyre të punës, ndonëse në kohën e intervistimit nuk kanë qenë duke punuar fare, derisa 8 për qind e respondentëve kanë thënë se kanë humbur vendin e punës për shkak të situatës së krijuar me Covid-19, sëmundje që shkakton koronavirusi.



## Shqipëria regjistron 42 raste të reja me Covid-19



TIRANË, 10 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë raportoi për rritjen e numrit të rasteve koronavirus në vend. Gjatë 24 orëve të fundit janë testuar 311 raste të dyshuara, prej të cilëve 42 kanë rezultuar pozitivë. Kjo është dita me numrin më të lartë të qytetarëve të prekur nga Covid-19. Specialistja e Institutit të Shëndetit Publik, Marjeta Dervishi, u shpreh se numri i pacientëve të shtruar në spital është rritur. "Vetëm në 24 orët e fundit janë testuar në spitalet infektive dhe 'Shefqet Ndroqi' 9

pacientë të dyshuar, të cilët janë konfirmuar pozitivë dhe janë shtruar në spitalin infektiv, ku vijon të rritet numri i të shtruarve, kryesisht nga Tirana", ka thënë Dervishi. Ajo ka bërë me dije se aktualisht janë 46 të shtruar pozitivë me Covid-19. "Është rritur numri i pacientëve që kanë nevojë për terapi intensive. Tetë prej të shtruarve janë në terapi intensive, njëri prej tyre në intubim, ndërsa një pacient ka dalë nga intubimi falë punës së stafit mjekësor të spitalit infektiv", ka thënë Dervishi.

Dervishi ka shtuar se, pavarësisht prej rasteve të reja që kanë ardhur në rritje në dy ditët e fundit, gjatë 24 orëve janë shëruar 20 pacientë, mes tyre mjekë dhe infermierë, duke e çuar numrin e të shëruarve në 980. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, në të gjithë vendin sot numërohen 327 raste aktive, kryesisht në Tiranë dhe Shkodër. Që nga përhapja e pandemisë e deri sot strukturat shëndetësore kanë kryer mbi 19 mijë teste dhe janë konfirmuar pozitivë 1 341 raste.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka prezantuar platformën e rimëkëmbjes kombëtare

# Veseli: Do t'i largojmë qeveritë e mashtrimit

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka prezantuar të mërkurën vizionin e ri të kësaj partie. Pas mbledhjes së Kryesisë të PDK-së, të mbajtur në këtë qytet, ai është zotuar se brenda vitit do t'i largojë nga pushteti në Prizren dhe Prishtinë qeveritë e mashtrimit dhe do ta rikthejë PDK-në në krye të shtetit. "Do t'i mbroj qytetarët dhe Kosovën nga mashtrimi, ndërsa asnjëherë nuk do t'i ik përgjegjësisë shtetërore dhe kombëtare. Me qëndrimin në opozitë, ne duam të jemi të përgjegjshëm para qytetarëve dhe votuesve tanë. Qeveria Hoti e ka të trashëguar virusin e mashtrimit të qeverisë Kurti. Këtë pandemi politike do ta ndalë vetëm PDK", ka thënë ai. Veseli ka deklaruar se kjo parti do të jetë opozitë për t'i hapur një derë të re një epoke të madhe të shqiptarëve. "Njerëz të rinj dhe ide të reja, do të jenë themeli i projektit tim të ri me PDK-në për Kosovën. PDK-ja do të angazhohet për një qeveri të vogël, por në funksion të rritjes së madhe të mirëqenies ekonomike, punësimit e cilësisë më të madh në arsim. Së shpejti në Kuvendin e Kosovës do ta iniciojmë nismën ligjore për procesin e ndëshkimit të krimeve të komunizmit në Kosovë. Ne jemi vendi i vetëm në Evropë që nuk e kemi përmbyllur këtë proces. E kemi obligim moral e shtetëror t'i njohim sakrificat e atyre që u ndoqën dhe u vranë nga regjimi komunist jugosllav", ka deklaruar ai, duke shtuar se PDK-ja do të angazhohet për drejtësi për mijëra viktime të pafajshme. Më tej, ai ka deklaruar se PDK-ja nuk mund t'i pranojë mashtrimet e atyre që premtojnë shumë dhe dështojnë gjithçka. "Shembulli tipik i kësaj është ky

Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka shpallur të mërkurën në Prizren vizionin e kësaj partie. Pas mbledhjes së Kryesisë së PDK-së, të mbajtur në këtë qytet, ai ka thënë se misioni i ri i kësaj partie ka për qëllim t'i largojë nga pushteti qeveritë e mashtrimit dhe ta kthejë PDK-në në krye të shtetit. Ai ka thënë se kjo është platforma e ideologjisë djathtiste që mbron vlerat tradicionale, ruan miqësitë dhe zhvillon lirinë



qytet i bukur, që duke u qeverisur me papërgjegjshmëri dhe korrupsion, ka ngufatur qytetarët dhe qytetin. Ky qytet ka humbur tri vjet nga keq-qeverisja e koalicionit të mashtrimit LV-LDK. Fatkeqësisht, shumë korrupsion e hajni, dëmtim të zonës historike e të potencialit të

turizmit. Ky koalicion mashtrimi, që braktisi qytetarët në Prizren këto ditë, e ndoqi shembullin e qeverisë 100-ditëshe të mashtrimit e status quos LV e LDK në qendër", ka thënë ai. Veseli ka vlerësuar se Prizreni, si gjithë Kosova, meritojnë qeverisje më të mirë. "Premtim

për autostradë me Tetovën nga Prizreni keni dëgjuar gjatë fushatës nga një parti që thirret në ngjyrat kuq e zi, por kurrë nuk e përmendi kur erdhi në pushtet, madje as që planifikoi buxhet për të siç kishte premtuar. Vitin e ardhshëm do t'ia kthejmë Prizrenit qeverisjen e PDK-së

ashtu si dhe gjithë Kosovës, me përkrahjen e madhe qytetare dhe do të qeverisim me njerëzit më profesionistë dhe më të mirë. Nuk ka kthim prapa. Ka vetëm fitore dhe ecje përpara", është shprehur Veseli.

I pari i PDK-së ka bërë me dije se platformën e re të kësaj partie do ta prezantojë edhe në qytetet e tjera të Kosovës. "Po e filloj ngadalë edhe prezantimin para qytetarëve të Kosovës të platformës sonë të rimëkëmbjes kombëtare. Platformë e ideologjisë djathtiste, që mbron vlerat tradicionale, ruan miqësitë dhe zhvillon lirinë. Angazhimi ynë është për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve kudo, moscenimin e kufijve të Kosovës, ruajtjen e lirisë dhe mbrojtjen e vlerave çlirimtare të popullit tonë. Do ta sanksionojmë me ligj çfarëdo cenimi të këtyre vlerave historike dhe luftën e drejtë të UÇK-së. Do të dënohet mohimi i krimeve të kryera nga Serbia dhe do të punojmë për të kërkuar drejtësi për çdo të vrarë e të zhdukur në Kosovë", është shprehur ai.

Ndër të tjera, lideri i PDK-së ka treguar edhe për qasjen që Kosova duhet ta ketë në raport me Shqipërinë. "Me shtetin që përfaqëson gjysmën e kombit tonë, ne do të lëvizim me një agjendë të përbashkët mbarëshqiptare të heqjes së barrierave ekonomike, tregtare dhe do të lëvizim me projekte të përbashkëta afrimi e jo ndarje e bllokim. Duhet unifikim i taksave dhe politikave doganore, po ashtu qëndrime strategjike unike. Na duhet bashkim forcash e idesh për ta çuar përpara agjendën integruese ndërsqiptare dhe atë evropiane", ka thënë Veseli. Për nder të 142-vjetorit të themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në këtë ditë Veseli ka bërë homazhe të shtatoret e Abdyl Frashërit, Ymer Prizrenit dhe Sylejman Vokshit.

## Shkon në 1 298 numri i të infektuarve me Covid-19 në Kosovë

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës ka njoftuar të mërkurën se ka testuar gjithsej 280 mostra të marra nga Klinika Infektive dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren dhe nga to janë konfirmuar 29 raste të reja me Covid-19. "Rastet

pozitive janë: nga Komuna e Prishtinës 13 raste, Komuna e Obiliqit 8 raste, Komuna e Vushtrrisë 2 raste dhe me nga 1 rast vendbanimet Zhiti-Viti, Lutogllavë-Prizren, Shushicë-Istog, Janjevë-Lipjan, Fushë-Kosovë dhe Rahovec", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.

IKShPK-ja, po ashtu, tha se të mërkurën është shëruar një pacient me të cilin numri i përgjithshëm i të shëruarve nga koronavirusi arrin në 913. Në Kosovë janë konfirmuar gjithsej 1 298 raste me koronavirus. Prej tyre, 31 pacientë kanë humbur jetën.



QEVERIA KA PREZANTUAR NË AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS KORNIZËN PËR

# HOTI: DIALOGUN ME SERBINË

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, e ka bërë të qartë të mërkurën, se dialogun me Serbinë do ta udhëheqë ai. Në prezantimin e kornizës së qeverisë për dialogun me Serbinë para akademikëve, Hoti ka thënë se për këtë çështje nuk do të bëjë garë me bartësit e tjerë institucionalë sepse drejtimin e këtij procesi ia garanton Kushtetuta. Kryeministri Hoti ka bërë me dije se ky proces do të jetë me parime dhe objektiva të qarta. Ndërsa akademikët e Kosovës kanë kërkuar që institucionet të arrijnë një konsensus nacional për dialogun me Serbinë

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka prezantuar të mërkurën në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës kornizën e Qeverisë së Kosovës për dialogun me Serbinë. Para anëtarëve të Akademisë, kryeministri Hoti ka deklaruar se që nga marrja e detyrës ka punuar intensivisht me kolegët e tij në kabinetin qeveritar dhe ka zhvilluar diskutime intensive me partnerët ndërkombëtarë për ta rikonfirmuar edhe një herë vullnetin e qeverisë për të hyrë në procesin e dialogut.

I pari i ekzekutivit ka treguar se procesin që do ta udhëheqë ai do të jetë me parime dhe objektiva të qarta. "Tani kjo është platforma dhe korniza jonë për dialogun. Dialogu do të zhvillohet vetëm mbi bazën e Kushtetutës së Kosovës.

Dialogun e udhëheqë kryeministri i vendit. Ka pasur diskutime nga më të ndryshmet javë dhe muajt e fundit. Unë nuk do të bëj kurrfarë gare me bartësit e tjerë institucionalë sepse kompetencat e mia kushtetuese janë të qarta për të gjitha çështjet, përfshirë edhe procesin e dialogut, në veçanti për procesin e dialogut kompetencat e mia si kryeministër janë betonizuar edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese", ka thënë Hoti.

Ai ka përmendur tri parimet bazike që do ta udhëheqin Kosovën në procesin e dialogut. "Parimi i parë është që integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i panegociueshëm. Unë nuk dua as si qytetar, as si kryeministër dhe as nuk kam mandat të diskutoj për integritetin territorial të Republikës së Kosovës. E dyta, në marrëveshjen që duhet të arrihet për normalizim të

marrëdhënieve për njohje reciproke, e cila duhet të sigurojë se konflikti në mes të Kosovës dhe Serbisë zhduket njëherë e përgjithmonë. Parimi i dytë është që organizmi kushtetues dhe shtetëror i Kosovës është i panegociueshëm. Nuk ka pushtet të ndërmjetëm. Dhe parimi i tretë, marrëveshja që

duhet të arrihet, duhet të jetë në përputhje me frymën e Kushtetutës së Kosovës", ka thënë ai. Më pas ai ka folur për objektivat që Kosova ka në këtë dialog. "E para është njohja reciproke. Nuk ka kuptim asnjë marrëveshje e cila nuk siguron njohje reciproke. Jo njohje reciproke të përkohshme, të

modeleve të dy Gjermanive ose të modeleve të tjera ndërkombëtare siç janë përmendur nëpër tryeza të ndryshme, por njohja reciproke që na siguron ulëse në OKB, na siguron menjëherë edhe njohje nga pesë vendet e BE-së që ende nuk na kanë njohur. Dhe, përtej kësaj ne pastaj futemi në procese të rregullta të anëtarësimit euroatlantik, në BE dhe në NATO", është shprehur ai. Sipas tij, objektivi i Kosovës në këtë marrëveshje është që t'i adresojë të gjitha çështjet e hapura mes të dy vendeve, të pagjeturit, dëmet e luftës, suksesionin e pasurisë së ish-Jugosllavisë, kthimin e pensioneve, artefakteve dhe një listë e gjatë e çështjeve që janë në pritje për t'u zgjidhur. "Unë besoj se me njohjen reciproke dhe me anëtarësimin në OKB këto çështje pastaj do të adresohen më lehtë dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare që duhet të zbatohen për t'i normalizuar marrëdhëniet në mes të dy vendeve", ka thënë Hoti.

## Akademikët kërkojnë unitet për dialogun me Serbinë

Akademikët e Kosovës kanë kërkuar që institucionet e Kosovës të arrijnë një konsensus nacional për dialogun me Serbinë i cili pritet të rifillojë së shpejti. Gjatë prezantimit të platformës së qeverisë për dialog në ASHAK, akademikët kanë vlerësuar se liderët institucionalë duhet të flasin me një zë për këtë proces. Kryetari i ASHAK-ut, Mehmet Kraja, ka thënë se besimi i popullit shpesh është shpërdorur nga liderët në Kosovë. "Një pjesë e faktorit të jashtëm e ka keqpërdorur besimin e Kosovës për dialog.

Faktori politik nuk duhet të jetë i ndarë, dikush që e dëshiron ShBA-në e dikush BE-në. Për marrëveshjet e deritashme nuk ka pasur interesim duke iu krijuar terren atyre që duan ta keqpërdorin atë", ka thënë ai. Kraja ka deklaruar se besimi i popullit shpesh është shpërdorur nga liderët në Kosovë. "Nuk ka Ahtisaari plus e as minus, se ndarja e Kosovës nuk mund të zëvendësohet si demarkacion, përkufizim, sikur që nuk mund të ketë Asociacion që e ndan Kosovën, edhe atëherë kur përmendet. Dhe, liderët jo rrallë kanë

shpërdorur besimin e popullit", ka pohuar ai. Edhe ish-ministri i Arsimit, akademik Arsim Bajrami, e ka ftuar kryeministrin Hotin që të punojë për ndërtimin e një konsensusi shtetëror për këtë proces. Ai ka shprehur optimizëm se kryeministri Hoti mund ta arrijë konsensusin e paarritur më parë mes presidentit, kryeministrit dhe Kuvendit të Kosovës. "Kosova duhet të jetë e përgatitur, konsensuale në dialog. Të krijohet konsensus shtetëror, të bëhen koordinimet e nevojshme me të gjitha partitë,

të koordinoheni me presidentin që ka kompetenca kushtetuese", ka deklaruar Bajrami. Ai ka thënë se kryeministri duhet të vazhdojë me këtë qasje bashkëpunuese në këtë proces. "Më pëlqeu qasja juaj që t'i jepni hapësirë me një komision opozitës për mbikëqyrje, por mos të shkojmë te përplasja se kush duhet të marrë merita, pasi meritat i ka shteti dhe duhet të bëhet konsensusi mes presidentit, kryeministrit dhe Kuvendit të Kosovës", ka deklaruar Bajrami.

DIALOGUN ME SERBINË

# E UDHËHEQ KRYEMINISTRI



## Lajçaku në javën e ardhshme fillon vrullshëm misionin negociator

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, pritet që në fillim të javës së ardhshme ta vizitojë Prishtinën. Kjo do të jetë vizita e tij e parë në Prishtinë që prej se mori postin e emisarit të BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më shumë se dy muaj më parë. Këtë lajm për "Radio Evropa e Lirë" e konfirmuan burimet diplomatike në Bruksel.

Nga zyra e Lajçakut ende nuk janë përgjigjur nëse ai do ta vizitojë edhe Beogradin apo do të qëndrojë vetëm në Prishtinë. Për shkak të vështirësive të udhëtimit, si pasojë e masave të vendosura kundër pandemisë së koronavirusit, Lajçak pritet që në Kosovë të vijë përmes Shqipërisë. Ai pritet të qëndrojë në Prishtinë për disa ditë.

Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së, Lajçak, në Prishtinë pritet të ketë një zyrë me tre këshilltarë. Ndërkaq, në Beograd ekipi i tij pritet të përbëhet nga pesë këshilltarë. Ai për dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, po ashtu në

Bruksel ka një ekip prej shtatë anëtarësh.

Gjatë vizitës në Kosovë, Lajçaku pritet të takohet me liderët politikë, me të cilët do të diskutojë për përgatitjet rreth rifillimit të dialogut. Por, ende nuk dihet nëse ai do të takohet me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili në disa raste ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë në dialogun e ndërmjetësuar nga Lajçaku, pasi diplomati që vjen nga Sllovakia nuk e njeht pavarësinë e Kosovës. "Në këtë moment nuk mund të komentojmë lidhur me asnjë takim që Lajçak mund të ketë", thuhet në përgjigjen e Zyrës së Lajçakut në Bruksel. As nga Zyra e Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, siç mëson "Radio Evropa e Lirë", nuk ka ndonjë ndryshim sa i përket gatishmërisë së presidentit të Kosovës për ta takuar zotin Lajçak.

Presidenti Thaçi në disa raste ka përmendur qëndrimet e Lajçakut kundër pavarësisë së Kosovës në kohën kur ky i fundit ishte ministër i Jashtëm i Sllovakisë. Madje Thaçi ka përmendur edhe votimin e Lajçakut kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe

INTERPOL.

Burimet në Bruksel, po ashtu, kanë konfirmuar se nuk ka pasur komunikim formal mes presidentit Thaçi dhe përfaqësuesit të posaçëm, Lajçak. Takimi i fundit ndërmjet Thaçit dhe Lajçakut ka qenë gjatë Konferencës së Sigurisë në Munihi të Gjermanisë para se Lajçaku të emërohej përfaqësues special për dialogun Kosovë - Serbi. Burimet diplomatike thonë se tentimet për të zhvilluar një bisedë telefonike ndërmjet Thaçit dhe Lajçakut kanë dështuar, duke potencuar se Thaçi ka dërguar porosi se "është i zënë me luftën kundër pandemisë së koronavirusit".

Burimet diplomatike në BE, megjithatë, shpresojnë se Thaçi do të bashkëpunojë me Lajçakun apo që Kosova do të emërojë një kryenegociator për dialog, me të cilin Lajçaku do të mund të jetë në kontakt të përhershëm për ta avancuar planin ambicioz për arritjen sa më të shpejtë të një marrëveshjeje.

Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim pritet ta kenë Gjermania dhe Franca, të cilat kanë mbështetur punën e zotit Lajçak.

Duke folur për organizimin e këtij procesi, ai ka treguar se për këtë ia ka zgatur dorën edhe opozitës. "Kemi menduar që fillimisht ta formalizojmë Forumin e Liderëve të Partive Politike Parlamentare, i cili do të jetë konsultativ, me qëllim që të ndërtohet konsensusi i nevojshëm politik në vend. Ky forum nuk do të marrë asnjë kompetencë që e ka kryeministri, që e ka Kuvendi, presidenti ose institucionet e tjera. Do të jetë një forum të cilin unë do ta informoj për qëndrimin që do ta mbajë si kryeministër në procesin e dialogut dhe pas çdo raundi të dialogut unë do t'i informoj në detaje për progresin që kemi arritur në procesin e dialogut", ka thënë ai, duke shtuar se brenda Zyrës së Kryeministrit do ta themelojë këshillin e ekspertëve për dialogun. "Këtu kemi menduar që të përfshijmë njerëz me ekspertizë nga shoqëria civile, nga fusha akademike, përfshirë Akademinë dhe institucionet e tjera akademike, njerëz që kanë përvojë në proceset dialoguese

nga negociatat, nga Rambujeja, nga negociatat e Vjenës dhe nga procesi i dialogut në vitet e fundit. Këshilli i ekspertëve do të ofrojë ekspertizë për kryeministrin, për ekipin tonë qeveritar që do të marrë pjesë në procesin e dialogut dhe për forumin e liderëve politikë, varësisht nga interesimi i tyre për të ofruar ekspertizën në fusha nga më të ndryshmet. Unë pres në këtë drejtim që Akademia e Shkencave ta ketë rolin qendror", ka deklaruar ai. Ai ka bërë me dije se për këtë çështje duhet të formohet edhe një komision parlamentar i cili duhet të udhëhiqet nga opozita. "E treta, sa i përket organizimit të procesit të dialogut, unë do të kërkojë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që ta themelojë një komision parlamentar për dialog në bazë të rregullores së Kuvendit, ku marrin pjesë të gjitha grupet parlamentare, të cilin komision duhet ta kryesojë opozita dhe i cili komision do të mbikëqyrë nga afër procesin e dialogut", ka thënë Hoti.



# Thaçi beson në arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë



PRISHTINË, 10 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se beson fuqishëm në përkushtimin e Shteteve të Bashkuara për të mundësuar arritjen e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Unë kam besim të plotë se vetëm me administratën e ShBA-së, të udhëhequr nga presidenti Donald Trump dhe rolin dinamik të ambasadorit Richard Grenell, gjërat do të lëvizin drejt një procesi produktiv dhe efektiv të dialogut dhe të ndonjë marrëveshjeje eventuale përfundimtare që sjell njohje reciproke si dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara", ka

deklaruar Thaçi.

Ai i ka bërë komentet të mërkurën pas homazheve që ka bërë te memoriali i ushtarëve të rënë të forcave të KFOR-it gjatë luftës në Kosovë. Thaçi ka theksuar se shteti i Kosovës ka hequr të gjitha pengesat për rifillimin e dialogut me Serbinë. "Besoj në zotimin e ShBA-së se do t'i ndër marrë hapat e duhur, në veçanti pas heqjes së barrierave që e pengonin vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. Serbia nuk ka më asnjë pretekst të vonojë, përkundrazi çdo vonesë i atribuohet asaj", ka deklaruar Thaçi. Sipas tij, Kosova në këtë proces duhet të jetë e bashkuar dhe pa dallime politike.

## Hoti: Angazhohemi për marrëveshje që do të rezultonte me njohje të ndërsjellë



**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka takuar të martën ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott, të cilit i ka treguar se qeveria e tij është e përkushtuar që të punojë për sundimin e ligjit dhe luftimin e

korupsionit.

Në një komunikatë për media, të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, është thënë se të dy zyrtarët kanë theksuar se integriteti territorial i Kosovës është i paprekshëm. Sa i përket çështjes së dialogut me Serbinë, kryeministri Hoti ka thënë se dialogu do të zhvillohet duke u bazuar në principe të qarta që burojnë nga Kushtetuta e

Kosovës. Sipas tij, Qeveria e Kosovës është e angazhuar për një marrëveshje që do t'i zgjidhte të gjitha çështjet e hapura me Serbinë dhe që do të rezultonte me njohjen e ndërsjellë.

Abbott në anën tjetër është cituar të ketë thënë se Britania e Madhe do të vazhdojë t'i përkrahë institucionet e Kosovës si vende partnere në

projekte të përbashkëta, të cilat synojnë zhvillimin e Kosovës, forcimin e demokracisë, sundimin e ligjit, ekonominë dhe meritokracinë në rekrutime. Kujtojmë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë është pezulluar nga nëntori i vitit 2018, kur autoritetet e Kosovës patën vendosur taksë 100 për qind në mallrat e Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës. Kjo masë

është zëvendësuar me reciprocitet, mirëpo qeveria e re e kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, ka hequr të gjitha masat për shkak të, siç është shprehur ai, heqjes së të gjitha pengesave për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011 në Bruksel.

## Ndërroi jetë nëna e heroit Fehmi Lladrovci

DRENAS, 10 QERSHOR (ER) - Të mërkurën i është dhënë lamtumira e fundit Shefkie Lladrovci, nënës së heroit të Fehmi Lladrovci. Ajo ndërroi jetë të mërkurën në orët e hershme të mëngjesit pas një sëmundje të

shkurtër.

Ngushëllime familjes Lladrovci i kanë shprehur përfaqësuesit e institucioneve të vendit, liderë partinësh, kryetarë komunash dhe përfaqësues të OVLUÇK-së.

Presidenti Hashim Thaçi ka ngushëlluar familjen Lladrovci, duke theksuar se familja Lladrovci ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës në të gjitha periudhat e lëvizjes

sonë kombëtare. "Familjes Lladrovci dhe gjithë miqve të saj i shpreh ngushëllimet më të thella për vdekjen e nënës Shefkie. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



# Macroni thotë se dialogu Kosovë - Serbi mund të rifillojë në Paris

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka uruar të mërkurën Avdullah Hotin për zgjedhjen kryeministër i Kosovës. Ai ka thënë se qeveria e re ka ardhur në çaste kyçe për Kosovën, veçanërisht për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Macron ka theksuar se Franca dhe Gjermania janë angazhuar për rifillimin e dialogut, i cili do të mund të fillojë gjatë një samiti të ardhshëm në Paris

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka marrë një telegram urimi të mërkurën nga presidenti i Republikës së Francës, Emmanuel Macron, i cili e ka uruar atë me rastin e marrjes së detyrës në krye të ekzekutivit të vendit.

Në telegramin e urimit të presidentit Macron thuhet se qeveria Hoti ka ardhur në një çast kyç për Kosovën. "Në emrin tim dhe në emër të popullit francez, ju dërgoj përgëzimet e mia të sinqerta dhe urimet e mia më të mira për sukses në ushtrimin e përgjegjësive tuaja të reja si kryeministër i Republikës së Kosovës. Franca, e cila ishte vendi i dytë që njohu Kosovën si shtet i pavarur një ditë pasi ajo shpalli pavarësinë dymbëdhjetë vjet më parë, ka qëndruar në anën e saj që nga ajo kohë. Unë do të doja t'ju shpreh gjithë solidaritetin tim dhe atë të popullit francez me popullatën e Kosovës, e sprovuar po ashtu nga pandemia Covid-19. Duke mobilizuar më shumë se 3 miliardë euro për t'i ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor

për të përballuar këtë krizë të paparë, Bashkimi Evropian ka treguar përkushtimin e tij të plotë për rajonin tuaj. Qeveria juaj e merr detyrën në një çast kyç për Kosovën. I takon asaj të ndërmarre reforma thelbësore: konsolidimin e shtetit të së drejtës, përfshirë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Franca do t'ju mbështesë në këto reforma në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe përafrimit evropian të vendit tuaj", thuhet në urimin e Macronit.

Ai ka thënë se kjo qeveri do ta ketë sfidë edhe dialogun me Serbinë. "Ju takon të përballeni me një sfidë tjetër thelbësore për Kosovën, duke rifilluar dialogun me Serbinë dhe duke rikërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes përmes një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, përfundimtare dhe ligjrisht detyruese. Prej më shumë se një viti, Franca dhe Gjermania janë angazhuar për rifillimin e dialogut, i cili do të mund të fillojë gjatë një samiti të ardhshëm në Paris. Unë besoj në pjesëmarrjen tuaj në këtë samit dhe në gatishmërinë tuaj për t'i marrë masat e

nevojshme për të bërë ta mundur rifillimin e dialogut, ndërkohë që Serbia duhet ta bëjë pjesën e vet të përpjekjeve", ka thënë presidenti francez.

Macron ka shtuar se sapo të rifillojë dialogu i takon ndërmjetësimit të Bashkimit Evropian t'i mbështesë përpjekjet e qeverisë së drejtuar

nga Hoti për të arritur një marrëveshje me Serbinë. "Roli i BE-së duhet të mbetet qendror, sepse kjo mosmarrëveshje është sfidë e sigurisë evropiane dhe sepse Kosova dhe Serbia kanë synim integrimin në Bashkimin tonë. Përfaqësuesi i lartë Josep Borrell dhe përfaqësuesi i ri special Miroslav Lajçak gëzojnë

besimin tim të plotë për të udhëhequr këtë ndërmjetësim. Duke shpresuar që t'ju takoj së shpejti dhe duke ripërtërirë urimet e mia më të mira për suksese në përgjegjësitë tuaja të reja, ju lutemi ta pranoni, z. Kryeministër, sigurinë e vlerësimit tim shumë të lartë", thuhet në urimin e presidentit të Francës, Emmanuel Macron.

## Ambasadori zviceran e cilëson të papranueshme gjuhën denigruese ndaj Osmanit

**PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER)** - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet. Në këtë takim, në të cilin u diskutuan çështje të bashkëpunimit mes dy vendeve, u ritheksuan edhe një herë raportet e shkëlqyera mes dy vendeve dhe u ritheksua përkushtimi për bashkëpunim ndërmjet dy vendeve.

Shteti i Zvicrës, si një ndër vendet e para të cilat e ka përkrahur pavarësinë e Kosovës, vazhdon ta përkrahë jetën demokratike në Kosovë. Ambasadori Lebet ka shprehur qëndrimin e vendit të



tij për ta ndihmuar procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, shteti zviceran e përkrah normalizimin e marrëdhënies mes dy vendeve si dhe mbron fuqishëm

paprekshmërinë e kufijve. Po kështu, ai ka shprehur mirëkuptimin e tij për qëndrimet e Osmanit për proceset politike në vend si dhe përkushtimin e saj ndaj vlerave demokratike

perëndimore. "Ne i japim mbështetje të pakursyer znj. Osmani në përkushtimin e saj dhe konsistencën në promovimin e vlerave demokratike", ka thënë ambasadori Lebet.

Ai vlerësoi se gjuha denigruese ndaj një personaliteti me integritet të lartë dhe të pakorruptuar si Vjosa Osmani, vetëm për shkak të mospërputhjes në qëndrime politike, është e papranueshme. Në anën tjetër, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, e ka falënderuar ambasadorin për vizitën dhe ia ka shprehur mirënjohjen e saj dhe të Kuvendit

të Kosovës për përkrahjen e vazhdueshme që Zvicra ia ka dhënë Kosovës. Ajo ka folur edhe për bashkëpunimin me vendet mike për promovimin e mëtejshëm të jetës parlamentare, për procesin e dialogut dhe për krijimin e paqes së qëndrueshme si dhe për shmangien e gjuhës së urrejtjes.

Osmani dhe ambasadori Lebet shprehën nevojën e një procesi transparent dhe të kujdesshëm për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit si institucion që kujdeset për afirmimin e të drejtave të njeriut dhe të një sistemi që siguron kontrollin e pushteteve dhe llogaridhënien.

## Ministri Kuçi dhe Selimi bisedojnë për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi është takuar të mërkurën me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, me të cilin ka biseduar për luftën kundër korrupsionit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka bërë me dije se kanë biseduar për planin e rimëkëmbjes ekonomike, për të krijuar një bazë ligjore sa më shpejt që është e mundur, për ta bërë implementimin e rimëkëmbjes ekonomike që është pjesë e programit të qeverisë 2020-2023. "Jemi bashkë me ministrinë e Drejtësisë, për ta dhënë mesazhin që sundimi i ligjit është bazë e zhvillimit ekonomik. Biseduam për koordinimin e dy ministrive për sundimin e ligjit. Edhe në programin tonë qeverisës 2020-2023 elementi bazë për zhvillimin ekonomik është sundimi i ligjit", ka

deklaruar Kuçi. Në lidhje me planin ekonomik për rimëkëmbjen e ekonomisë së goditur nga pandemia Covid-19, Kuçi ka deklaruar se e kanë në dispozicion vendimin e qeverisë Kurti sa iu përket masave emergjente dhe përkrahjes së bizneseve private. Ai ka pohuar se ato vendime do të implementohen por, siç ka thënë ministri, ka edhe problem ligjore. Kuçi ka theksuar se implementimi është i pamundshëm në qoftë se nuk shkohet drejt rishikimit të buxhetit dhe ka kërkuar që Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim për t'i implementuar vendimet e qeverisë Kurti. Kurse ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka theksuar se sundimi i ligjit është baza e rimëkëmbjes ekonomike dhe ka pohuar se Ministria e Drejtësisë me kapacitet që i ka do të jetë në dispozicion të plotë të implementimit të këtij plani.



## Ngrehet çmim i bukës, i pemëve, i veshjeve dhe i pajisjeve shtëpiake

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin maj 2020, viti bazë 2015=100. Në një komunikatë për medie, ASK-ja ka bërë me dije se ngritje e çmimeve vërehet të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (0.4 për qind); pemë (2.1 për qind); veshje (0.6 për qind); pajisje shtëpiake (1.2 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.1 përqindësh në IHÇK. Sipas ASK-së norma vjetore e inflacionit e matur në muajin maj 2020 me muajin maj 2019 ishte 0.2 për qind. "Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (1.9 për qind); mish (2.7 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (5.9 për qind); vajra dhe yndyrëra (3.5 për qind); pemë (13.3 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (4.7 për qind); produkte të ndryshme ushqimore, kripëra, erëza etj., (3.1 për qind); kafe, çaj dhe kakao (8.0 për qind); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemë dhe perime (2.6 për qind); pije alkoolike (0.7 për qind);



energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (0.5 për qind) - (ngritje e çmimeve të drunjve për ngrohje); pajisje shtëpiake (1.3 për qind); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake

(1.5 për qind); produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (5.1 për qind); shërbime ambulatorie (7.3 për qind); blerje e automjeteve (1.3 për qind); shërbime hoteliere (2.6 për qind); gjëra personale (4.1 për qind); sig-

urime (19.3 për qind) - (ngritje e çmimeve të sigurimeve të automjeteve), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2.0 për qind në IHÇK", thuhet në raportin e ASK-së. Sipas ASK-së, inflacioni mujor i

matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit ishte (-0.3 për qind) në muajin maj 2020, krahasuar me muajin prill 2020. "Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: perime (-5.9 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-0.4 për qind) - (rënie e çmimeve të gazit dhe drunjve për ngrohje); përdorimi i pajisjeve për transportin personal (-2.6 për qind) - (rënie e çmimeve të naftës dhe benzinës), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.4 për qind) në IHÇK", thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: perime (-10.5 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (-18.8 për qind) - (rënie e çmimeve të naftës dhe benzinës), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-1.8 për qind) në IHÇK. "Ndryshimet e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të disa nëngrupeve pa ndonjë ndikim në IHÇK. Për më shumë informata lidhur me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin maj 2020", ka theksuar në raportin e ASK-së.

## Anulohen fluturimet e parapara nga Aeroporti i Prishtinës

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Aeroporti i Prishtinës "Adem Jashari" ka bërë me dije se janë

anuluar fluturimet e planifikuara komerciale në nisje deri më 14 qershor. "Ju njoftojmë se deri më

14 qershor 2020 nuk ka fluturime. Fluturimet që janë publikuar më herët për datat 13 dhe 14 qershor

2020 janë anuluar nga kompanitë ajrore", është thënë në njoftimin e ANP-së.





# Banka Botërore përkrah Kosovën me 25.1 milionë euro në projektin për furnizim me ujë

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë i Bankës Botërore ka aprovuar programin "Nxitja dhe lejimi i mundësive për sigurinë e ujit në Kosovë", i cili synon ta forcojë kapacitetin e Kosovës për administrimin e sigurisë së ujit në nivelin kombëtar dhe ta përmirësojë sigurinë e ujit në basenin e Moravës së Binçës, që është rajoni më i thatë në Kosovë.

Mbështetja e miratuar financiare për projektin është 25.1 milionë euro (e barasvlershme me 27.4 milionë dollarë). "Banka Botërore po e mbështet Kosovën për ta adresuar krizën e ujit në nivelin kombëtar dhe specifikisht mungesën e ujit në zonën e basenit të Moravës. Përveç përfitimeve të rëndësishme të zhvillimit nga përmirësimi i furnizimit dhe forcimi i menaxhimit të resurseve ujore në Kosovë, disponueshmëria e ujit dhe e masave sanitare janë barrierë esenciale ndaj përhapjes së viruseve dhe për mbrojtjen e shëndetit njerëzor nga Covid-19 dhe sëmundje të ngjashme", ka deklaruar Marco Mantovanelli, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Në komunikatën e Bankës Botërore thuhet se përtej përfitimeve të menjëhershme, programi synon ta zhvendosë në mënyrë themelore situatën e pasigurt të ujit në Kosovë. "Për krahasim rajonal, Kosova ka

shtrëngesë ujore, resurse ujore tejet të ndotura dhe nivelet e saj të depozitave ujore janë ndër më të ulëtat. Zgjerimi i boshllëkut midis kërkesës në rritje për ujë dhe sasive të disponueshme të ujit me cilësi të mirë po çon në mungesë uji dhe ndërprerje të furnizimit me ujë dhe shërbime të ujitjes. Thatësira dhe tronditjet nga përmytjet pritet të bëhen më të shpeshta dhe të rënda për shkak të ndryshimeve klimatike. Përveç shtrëngesës fizike ujore, Kosova ka pasiguri të ujit për shkak të menaxhimit të dobët të resurseve në dispozicion", theksohet në këtë komunikatë.

Më tej thuhet se "projekti i aprovuar do të shtojë edhe themelin për zhvillimin dhe menaxhimin strategjik të depozitimit të ujit në të ardhmen, përmirësimin e njohurive rreth ujërave në vend për t'u ballafaquar me thatësira, përmytje dhe për t'i përmirësuar shërbimet, si dhe përmirësimin e menaxhimit të sigurisë së digave për komunitetet në rrjedhën e poshtme. Projekti do të investojë në mënyrë të konsiderueshme në lartësimin e nivelit të shërbimeve të furnizimit me ujë në zonën e menaxhuar nga ndërmarrja e ujësjellësit 'Hidromorava'. Ai, gjithashtu, do t'i financojë studimet teknike, sociale dhe mjedisore për të lejuar një vlerësim të detajuar për të investim përcjellës potencial për zgjerimin e kapaciteteve për depozitimin e ujërave të sistemit



hidrik 'Kikë-Kremenata' në juglindje të Kosovës. Përveç kësaj, projekti ka nënkomponentë që mbështet rimëkëmbjen ekonomike përmes granteve për komunitetin dhe krijimin e vendeve të punës gjatë implementimit", bëhet me dije në komunikatën e Bankës Botërore.

Sipas kësaj komunikate, të gjithë qytetarët e Kosovës, veçanërisht fermerët, do të përfitojnë nga shërbimet e begatuara hidrometeorologjike, mbrojtja e pellgjeve ujëmbledhëse, masat agro-mjedisore dhe mundësitë

ekonomike që do të rezultojnë. "Të gjitha komunitetet në rrjedhën e poshtme të digave në Kosovë do të përfitojnë nga rritja e vëmendjes ndaj mirëmbajtjes dhe sigurisë së digave, risku i reduktuar nga përmytjet dhe gatishmëria më e mirë emergjente. Do të reduktohen risqet nga thatësira duke e bërë të mundur përdorimin e kapacitetit të depozitave të pashfrytëzuara aktualisht të ujit. Përmasat e shërbimit e përmirësuar të ujit, nga projekti do të përfitojnë drejtpërdrejt rreth 190 000 qytetarë që banojnë në basenin e Moravës së Binçës, në juglindje të

Kosovës. Projekti FLOWS financohet me kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (në gjuhën angleze International Development Agency, shkurt IDA) e Grupit të Bankës Botërore. Kreditë e IDA-s jepen me kushte koncesionare me interes zero ose shumë të ulët dhe periudha të gjata të kthimit. Financimi i këtij projekti ka afat maturimi prej 25 vjet dhe grejs periudhë pesëvjeçare. Projekti do të implementohet gjatë një periudhe prej 5.5 vjet nga Qeveria e Kosovës", ka përfunduar komunikata e BB-së.

## Mehmeti dhe Shahini diskutuan për lehtësimin në qasjen e financave



PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e Aleancës Kosovare të Bizneseve, të kryesuar nga kryetari Agim

Shahini. Guvernatori Mehmeti i ka njoftuar përfaqësuesit e AKB-së me zhvillimet në sektorin financiar pas lehtësimit të masave dhe planet e ardhshme të BQK-së me qëllim të dhënies së ndihmës

për ta rimëkëmbur ekonominë, për çka BQK-ja mbetet e përkushtuar të kontribuojë për lehtësimin e mëtejshëm të qasjes në financa. "Në këtë takim u shpalosen sugjerimet e BQK-së për kontributin që sektori

financiar mund të japë për të ndihmuar në përmirësimin e situatës ekonomike në vend. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e AKB-së paraqitën pikëpamjet e tyre për mënyrën se si mund të ndihmohet ekonomia për t'u rimëkëmbur më

lehtë si dhe falënderuan BQK-në për ndërmarrjen e masave të menjëhershme për t'i dalë në ndihmë ekonomisë dhe qytetarëve me masat e ndërmarrja", thuhet në njoftimin e BQK-së.

## Komuna e Gjilanit miraton rishikimin e buxhetit

GJILAN, 10 QERSHOR (ER) - Kuvendi Komunal i Gjilanit, të mërkurën në një seancë të jashtëzakonshme, të kryesuar nga Shpresa Kurteshi-Emini, ka miratuar rishikimin e buxhetit për vitin 2020.

Zijadin Maliqi, drejtor i Financave, ka thënë se Ministria e Financave përmes një shkresë drejtuar komunave

ka kërkuar rishikimin e buxhetit në funksion të pandemisë. Ai ka thënë se mundësitë për rirregullim të buxhetit nuk kanë qenë të mëdha dhe vetëm disa mjete kanë mundur t'i bartin nga një projekt te projekti tjetër, në shumën rreth 500 mijë euro. "Si te bujqësia, ku rrugët e arave nuk kanë mundur të kryhen për shkak të pandemisë dhe

tani barten te asfaltimi i rrugëve, pastaj te shëndetësia dhe disa të tjera, në kuadër të kategorive të caktuara", është shprehur Maliqi.

Drejtori Zijadin Maliqi sqaroi se rishikimi i buxhetit dhe riorientimi i mjeteve është bërë prej drejtorive, duke shtuar se riorientimi i mjeteve jashtë kategorisë nuk mund të bëhet.



## Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit 'Up to Youth'

MITROVICË, 10 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të mërkurën në një takim drejtorin e programit "Up to Youth", Daniel Cruz, me të cilin kanë nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për realizimin e projektit "Up to Youth", projekt ky i cili financohet nga USAID-i. Projekti "Up To Youth" është aktivitet pesëvjeçar i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe ka për qëllim mobilizimin e rinisë për të qenë forcë e ndryshimeve pozitive, zhvillimin dhe demonstrimin e shkathtësive të buta/jetësore për rininë, si dhe mbështetjen e partnerëve të qëndrueshëm për kultivimin e një mjedisi ku rinia mund të përfshihet në mënyrë pozitive të dobishme.

Gjithashtu, programi i këtij pro-



jehti zhvillohet edhe në tre komponentë kryesorë: për-

forcimin e të rinjve që të bëhen forcë e ndryshimeve në komu-

nitet, të rinjtë të pajisen me aftësi dhe shkathtësi të buta

përmes trajnimeve si dhe përforsimi i komunikimit në mes të institucioneve dhe të rinjve.

Kryetari Bahtiri, duke i falënderuar për vizitën si dhe duke çmuar lart bashkëpunimin që Komuna e Mitrovicës ka pasur ndër vite me USAID-in, e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm realizimin e këtij projekti në Mitrovicë sepse është më se e nevojshme përfshirja e të rinjve në aktivitetet që zhvillohen brenda komunitetit ku jetojmë. "Të rinjtë duhet të stimulohen si dhe të vetëdijeshohen që të bëhen pjesë e aktiviteteve që ndodhin brenda komunitetit sepse nuk mund të kemi një shoqëri të denjë dhe të shëndoshë pa përfshirjen e të rinjve në procese të ndryshme", ka thënë Bahtiri.

Në fund të takimit palët janë pajtuar që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Hapen shkollat dhe çerdhja në Malishevë

MALISHEVË, 10 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Malishevës të mërkurën janë hapur të gjitha shkollat, përkatësisht klasat e nënta, po ashtu është hapur edhe çerdhja. Kjo është bërë me dije nga drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, i cili edhe i ka vizituar disa nga shkollat për ta parë nga afër procesin e hapjes së shkollave për klasat e nënta për parapërgatitjet për testin e arritshmërisë. Sipas drejtorit Thaçi, komuna i ka marrë të gjitha masat e sigurisë në raport me pandeminë Covid-19, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të nxënësve dhe mësimit. "Kemi bërë dezinfektimin e shkollave dhe të çerdhes, po ashtu kemi pajisur nxënësit me

maska si dhe të gjitha shkollat janë pajisur me dezinfektues për duar", ka thënë drejtori Thaçi.

Ai së bashku me zyrtarët e drejtorisë që drejton kanë zhvilluar një takim me komandantin e Stacionit Policor në Malishevë, kapitenin Azem Krasniqi dhe zyrtarët e tjerë përgjegjës policorë, me të cilët kanë biseduar për bashkëpunimin në mes të dy institucioneve për hapjen e shkollave dhe zbatimin e masave mbrojtëse në raport me Covid-19 si dhe për mbarëvajtjen e mësimin.

Po në këtë takim është bërë me dije se Policia e Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim dhe Edukim do të mbajnë edhe ligjërata për masat mbrojtëse në raport me pandeminë.



## Fillon shpërndarja e kontejnerëve për mbeturina në Lipjan

LIPJAN, 10 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Lipjanit ka filluar shpërndarja e kontejnerëve për familjet që nuk kanë kontejnerë të tillë, po ashtu me dorëzimin e kontejnerit është bërë edhe kontrata për ta shmangur hedhjen e

mbeturinave vend e pa vend. Ky projekt është bashkëfinancim në mes të komunës së Lipjanit dhe Kompanisë "Pastrimi". I pari i komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka pohuar se çdo familje do të ketë

shportën, ku njëkohësisht do të krijohet edhe një listë e lirimimit nga pagesa për familjet që janë me asistencë sociale. Pas shpërndarjes së këtyre shportave do të fillojnë masat ndëshkimore ndaj personave që

hedhin mbeturina në vende të ndryshme e që dëmtojnë ambientin.

Shpërndarja e kontejnerëve ka filluar në Janjevë, Sillovi dhe do të vazhdojë edhe në fshatrat e tjera në ditët e ardhshme.



Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (3)

# 7 marsi i 1998-s



**Bedri ISLAMI**

Ishte 7 marsi i vitit 1998 kur fillon e ngjizet legjenda, miti dhe e vërteta e tyre. Dëborë kishte filluar të shkrihej, ditët tashmë nuk do ta kishin kuptimin e tyre të zakonshëm. Mbi Prekazin e Poshtëm nuk do të kishte heshtje më. Ajo që kishte ndodhur do të ishte tepër e përkohshme, aq e përkohshme saqë askush nuk do të kishte marrë me mend. E gjitha kjo kishte pasur një fillësë, një fillësë të hershme dhe një tjetër tepër ngjat. Për të ditur gjithçka që kishte ngjarë, do të ishte mirë të ktheheshim pak më pas. Le të nisim me atë që është tepër ngjat.

## Tri ditë më parë

Pesha e forcës së një burri është në qëndresën që ai mposht.

Në orët e vona të 4 marsit të vitit 1998, kur nata ishte gjithkund mbi luginat dhe vargëzimet e bjeshkëve përreth, një grup i vogël njerëzish, pasi ishte shkëputur nga fshati Ticë, kishte marrë rrugën drejt Prekazit të Poshtëm. Ecnin të heshtur, të dukej sikur vetëm era rrëshqiste së bashku me to dhe krejt normale dukeshin shumë më të gjatë sesa do të ishin në të vërtetë. Kishin një përzgjatje të çuditshme, por vetëm herë pas here, kur dilnin në ndriçimin e hënës së ftohtë, dukeshin se kishin armë me vete. Ishte një fillim pranverë që dukej se do të vinte tepër shpejt dhe brymëzat e ngrira të ngjanin me fillimin e gjurmëve të shkrirjes së dëborës.

Njerëzit lëviznin ngadalë, të heshtur, vetëm nganjëherë njëri prej tyre, ai që ishte në mes, i thoshte me zë të ulët njeriut që kishte para tij, të bënte kujdes, se toka ishte ende e rrëshqitshme. Ishte për to çdo gjë e njohur në atë rrethinë rreth e qark saqë, edhe po të kishin pasur sytë e mbyllur, përsëri do ta kishin pasur fare të lehtë të gjenin udhën nga shkonin. Më shumë se një ecje e detyrueshme, të dukej sikur po ndodhte një rikthim në shtëpinë e tyre. Ashtu do të ishte vërtet, ishte një çast kur gjithçka të duket se është e zakonshme dhe me plot mall, të duket sikur, pas çdo kthese në mal apo pas bardhësisë së bjeshkëve, do të rishfaqen kullat e fisit, vendet ku ke lindur dhe ku e di se do të jesh vazhdimisht.

Asnjëri prej tyre nuk e dinte se ky do të ishte udhëtimi i tyre i fundit nëpër rrugëtimet e Kosovës. Nuk mund ta dinte se pas kësaj nate do të vinin tri ditë të jashtëzakonshme të cilat do të tronditnin gjithçka. Nuk kishin se si ta dinin, megjithëse përherë e

kishin menduar se pas çdo çasti të zakonshëm, mund të vinte edhe çasti i tyre i fundit, ndaj edhe kishin jetuar në secilën ditë, sikur të ishte dita e tyre e fundit. Më saktë, kishin luftuar çdo ditë si të ishte dita e tyre e fundit e luftës. Ishin në njerëzit që e kishin matur kohën disi ndryshe nga të tjerët. Jo me ditë të zakonshme, me ditë-net apo me natë-ditë, ata e kishin matur me ditë lufte dhe, pasi e kishin matur një herë kështu, në një natë funddhjetori të vitit 1991, e kishin ditur se e kishin mirë dhe kishin vazhduar. Qetësisht, pa asnjë lloj zhurme e dëliri, si për çdo gjë të zakonshme që kishin bërë deri asaj dite. Njëllor si të lëronin tokat që i kishin në blerinat afër shtëpisë, si të pritnin dru në mal, si të dilnin me miqtë e me shokët për një bisedë të zakonshme, si t'i kositnin livadhet ku rritej bari erëmirë i Kosovës, si të prisnin miq e dashamirë, si të ngrinin kulla dhe të bënin dasma.

Ata ecnin ngadalë. Kishte qenë një vendim i papritur ky rrugëtim. Ndoshta një çast malli, ndoshta dëshira për një prehje të shkurtër, ku ta dish, malli për prindërit, fëmijët, e pastaj do të vinte krejt normalisht një ditë e nesërme, mrekuillisht e bukur, sepse edhe ajo do të ishte ditë lufte, e njëkohësisht krejtësisht e zakonshme, sepse lufta u ishte bërë shprehi.

- Dajë, a shkojmë sonte nga shtëpia. Edhe shohim robtë e shtëpisë, edhe çmallet me motrën. Si thua, - kishte pyetur njëri nga nipërit dhe Osman Geci, daja i shtëpisë, kishte tundur kokën lehtë, si të thoshte se "shkojmë, pse jo".

Thuhet se nipi qet pushkë për dajën, e daja qet top për nipin. Këtë fjalë të hershme e kisha dëgjuar për herë të parë në bjeshkët e Dukagjinit, shumë e shumë vite më parë. Më është kujtuar shpesh herë, sidomos pas kësaj nate, e cila ishte njëkohësisht edhe nata e fillësës së një ndriçimi të jashtëzakonshëm.

Nata e 4 marsit tashmë ishte thyer plotësisht. Hapat e tyre rrëshqisnin nëpër natë dhe të dukej sikur vetëm era përcillte hapëzimin e tyre.

Nga larg kishin parë tri kullat e shtëpisë së tyre dhe kishin shpejtuar hapat. Po ktheheshin nga një fillësë lufte, sapo ishin ndarë me disa nga shokët e miqtë e tyre, kishin parë plagët e të plagosurve në luftimet e para pak ditëve, dhe, ndoshta e kishin menduar se plagë të tilla do të vinte koha që do të ishin krejt të zakonshme, ndoshta në të gjithë truallin e Kosovës.

Jeta që kishin bërë deri atëherë në fakt do të ishte e gjitha. Më pas do të nisnin tri ditë-net, që aq sa kishin lidhje me tërë ditët e tyre, aq do të ishin edhe jashtë të zakonshmes, do të ishin tri ditëlidhëse mes asaj që kishte ndodhur deri ato çaste dhe asaj që do të vinte më pas.

Kishin mbetur jo më shumë se dyqind metra larg hyrjes kryesore të kullave të tyre dhe bënë më tej me ndjenjën e ngrohtë që të krijon afrimi i shtëpisë. Po bëheshin shtatë vite që në këto kulla ishin të përkohshëm, ishin gjysmë miq dhe gjysmë bujtës, ishin, si të thuash, dalzotësit e kullave, por njëkohësisht edhe të përkohshmit e tyre.

Askush nuk e dinte, aq më pak nuk e dinin tre njerëzit që po ecnin drejt Prekazit të Poshtëm, se njëkohësisht me to, por tashmë nga disa drejtime të ndryshme, po lëviznin dhjetëra makineri lufte, nuk mund ta dinin se vetëm pak çaste më vonë, vetëm pak çaste pasi ata të futeshin në vatrën e tyre, do të lëviznin 200 mjete të blinduara dhe 15 topa do të kishin një objektiv të vetëm, tri kullat e Fisit të tyre. Nuk mund ta dinin se një ecje e tyre nëpër natë do të vinte në lëvizje një përbindësh të tërë hekuri, municioni dhe armësh, të cilët si në krijimet e përbindshme, kishin qenë prej ditësh në këtë pritje të ankthshme. Një shtab i tërë do të vihej në lëvizje për atë që ishte përgatitur prej javësh e ndoshta muajsh, ushtarakë të lartë, paramilitarë të përçartur, banda çetnike, grupe që kishin përgjakur krahina të tëra në Bosnje e në Kroaci, kriminelë të të gjithë llojeve, gjeneralë dhe Arkani i çartallosur, të gjithë ata që mund të vinte në lëvizje një pushtim i dhunshëm, kishin filluar tani të kishin një drejtim të vetëm, Prekazin.

Ata nuk mund ta dinin se në fillimin e mëngjesit që do të vinte, pak pas mesnatës, drejt tyre, nga drejtimi i Mitrovicës për në Skenderaj do të arrinte kolona e parë e forcave të policisë serbe, nuk mund ta dinin se në fabrikën e Municionit, as treqind metra përballë banesave të tyre kishin zënë vend forca të tjera të përqendruara serbe, nuk mund ta dinin se pak çaste më vonë, nga Prishtina drejt tyre do të nisej kolona elitë e forcave serbe në Kosovë.

Ishte vënë në lëvizje një makineri e përgatitur shumë kohë më parë. E dhunshme, e përgjakshme, e egërsuar. Kishin hesap të hershme me njerëzit e këtyre e

kullave dhe, si dukej, kishin menduar se në një natë ose në një çast natë-ditë do të merrte fund gjithçka, e bashkë me to, do të merrte fund edhe ideja e tyre. Do të kishte dy humbje të njëkohshme, kishin menduar në Beograd, të atyre njerëzve që ishin brenda kullave dhe prej nga ishin kthyer të mundur dy herë, por edhe të idesë së tyre. Nuk do të kishte më asgjë, pas rrethimit të kësaj nate dhe asaj që pritej në fillimin e ditës së nesërme, do të kishte vetëm heshtje, një qetësi mortore, e paskajshme, e aftë për të vendosur heshtjen për dhjetë vitet e ardhshme në këtë vend rebel. Dhe nëse shuhej kryeqendra e rebelëve dhe rebelët bëheshin të pakundgjetur, do të ishte e natyrshme që nuk do të kishte më asgjë pas kësaj. Kështu kishin menduar në Beograd. Do të ishin dy herë të gabuar. Nuk do të ishte thjeshtë një larje hesapësh, e befasishme dhe asgjë tjetër, e po ashtu nuk do të kishte pasur heshtje të mëtutjeshme.

Të tre udhëtarët e natës së 4 marsit ndërkohë ishin çmallur me njerëzit e shtëpisë, kishin marrë pranë vetes nënën e tyre, e cila, e struktur në gjoksin e madh të bijve të saj, dukej sikur kishte humbur mes tyre. Ishin ulur pranë vatrës, pikërisht aty ku kishin qëndruar me dhjetëra e qindra herë, kishin dëgjuar natën që po fillonte të thyhej dhe ishin ndjerë mirë, si çdo njeri në vatrën e tij.

Nuk e kishin ditur, dhe nuk do e dinin deri në mëngjesin e afërt, se ishin vënë njëkohësisht në lëvizje, disa njerëz të zakonshëm që shkonin drejt vatrës së tyre dhe qindra e qindra mjete për të shuar jetën e tyre.

Do të duhej të kishte ndodhur diçka e jashtëzakonshme që një armatë e tërë serbe, si kurrë ndonjëherë më parë, me përmasat e saj oktopodhiane si metastaza të zeza, ishte vënë ashtu në lëvizje, ose njerëzit që ishin brenda kullave do të duhej të ishin vërtet të jashtëzakonshëm. Nuk kishte se si të ndodhte ndryshe.

Në fakt të dyja ishin të vërteta, për armatën serbe kishte ndodhur diçka e jashtëzakonshme, kishte filluar

thyerja e saj. Deri atë natë thyerja kishte qenë e ngadalshme, por që do të bëhej e rrokopujshme, dhe thyerja kishte nisur pikërisht në këto vise, në pikëtakimin e këtyre kullave me vazhdimin e bjeshkëve, nga këto njerëz, që në 30 dhjetorin e vitit 1991. Kishte filluar dhe po vazhdonte, gjithnjë e më shumë, nëse deri atëherë ajo kishte qenë e padukshme, tashmë krisja e thyerjes po merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha, po shtrihej në hapësira përherë e më të gjëra.

Kishin provuar të ndalonin hemorragjinë e krisjes, e kishin provuar sërish në janarin e këtij viti dhe përsëri ishin thyer, përsëri në të njëjtin vend, nga të njëjtët njerëz; pastaj kishin ndodhur thyerje të tjera, një herë në Likoshan, pastaj në Llaushë, pritej thyerja në Dukagjin, në zonën e Llapit ku tani po dëgjohej kudo një këngë e re për Ali Ajetin, nuk dihej se cila do të ishte thyerja tjetër. Për to, kjo thyerje duhej ndaluar, e për të ndaluar këtë, në radhë të parë duheshin thyer këto njerëz, të cilët, krejt normalisht dhe pa e kërkuar, po bëheshin në simbol, po niste të ndërtohej fillësa e legjendës së tyre dhe kjo legjendë duhej shkelur përgjakshëm që në agun e saj. Duhej ndërprerë jeta e tribunëve për të pasur një pushtim të gjatë, shumë të gjatë, mundësisht sa më të qetë dhe me lojën e pluralizmit, sa herë që të donin. Askush nuk i prishte punë më shumë se ky trekëndësh kullash, në këtë fshat që po bëhej ngadalë kryeqendra e Kosovës. Nëse nuk do e thyenin këtë, atëherë ishte krejt e mundur që kjo të bëhej zanafilla e një kryeqendre gjithëshqiptare, rreth së cilës njerëzit të përulëshin me përkushtimin e duhur, dhe me ndjenjën se e kishin gjetur tashmë vendin që kishin kërkuar për të ngulur shtizën e mëvetësisë së kombit të tyre. Duheshin zhdukur flamurtarët, duhej zhbërë miti i tyre, ende pa u bërë i plotë, duhej treguar se askush, edhe më i besuari prej tyre, "shifterve", nuk mund të i bënte ballë furisë ndëshkuese të tyre.

Ky do të ishte thelbi i lëvizjes nëpër natë të një armate të tërë serbe ndaj një vendbanimi shqiptar. (Vijon)



## Fauci: Kriza me koronavirus nuk ka përfunduar ende

UASHINGTON, 10 QERSHOR - Drejtori i Institutit Kombëtar për Alergjji dhe Sëmundje Infektive në Shtetet e Bashkuara, Anthony Fauci, ka thënë se pandemia me

koronavirus nuk "ka përfunduar ende", derisa të njëjtën e ka përsëritur si "ankthin më të keq". "Në një periudhë prej katër muajsh ka shkatërruar gjithë botën", ka thënë ai në

një konferencë për media, duke shtuar se "miliona e miliona njerëz janë infektuar në gjithë botën. Kjo konsiderohet të ketë ndodhur në periudhë shumë të shkurtër".

Eksperti i Shtëpisë së Bardhë për koronavirus i ka bërë këto komente në një konferencë të organizuar nga Organizata për Bioteknologji Inovative.



## Suedia mbyll rastin rreth vrasjes së ish-kryeministrit Olof Palme



Stokholm, 10 qershor - Suedia ka mbyllur hetimet rreth rastit që lidhet me vrasjen e ish-kryeministrit suedez Olof Palme i cili është qëlluar për vdekje më 1986 në Stokholm. Prokurori i këtij rasti, Krister Petersson, ka thënë më 10 qershor se ky rast do të mbyllet, pasi Stig Engstrom, i dyshuari kryesor i rastit, ka vdekur më 2000. Palme ishte qëlluar me armë zjarri më 28 shkurt të vitit 1986, pasi ai dhe gruaja e tij, Lisbeth Palme, ishin larguar nga një kinema në Stokholm.

Engstrom, që ka kundërshtuar qasjen e së djathtës së Palmes dhe ka qenë afër skenës së vrasjes, është marrë në pyetje nga policia si dëshmitar, mirëpo nuk është treguar i besueshëm pasi ka ndryshuar deklaratën disa herë. Ai më pas ka kryer vetëvrasje në vitin 2000. Kjo vrasje pati shokuar Suedinë, një prej shteteve me shkallën më të ulët të vrasjeve në botë. Christer Petersson, kriminel dhe vrasës, ishte dënuar për këtë rast, ndonëse më vonë është përmby-

sur edhe ky vendim i gjykatës. I dyshuari tjetër Victor Gunnarsson, që ka emigruar në Shtetet e Bashkuara, është raportuar se ka vdekur më 1993 në teritorin amerikan. Hetuesit kanë shqyrtuar një mori skenarësh dhe më shumë se 100 persona kanë dëshmuar për këtë rast. Palme ka udhëhequr si lider i Partisë Social-Demokrate nga viti 1969 derisa ka vdekur dhe ka qenë kryeministër i këtij shteti në periudhat 1969-1976 dhe 1982-1986.

## Austria rihap kufirin me Italinë pa kufizime

VJENË, 10 QERSHOR - Austria njoftoi të mërkurën se do ta rihapë kufirin me Italinë nga data 16 qershor dhe se do ta lejojë udhëtimin e lirë nga shumica e vendeve evropiane, po nga kjo datë. Javën e kaluar ajo i ka hequr kufizimet në udhëtim për disa shtete fqinje, por e ka përfunduar Italinë - njërin nga vendet e goditura më së keqi nga pandemia e koronavirusit në Evropë. "Po, po e hapim kufirin.

Për shembull, udhëtimi në Itali, Greqi, Kroaci do të jetë i mundur", tha ministri i Jashtëm i Austrisë, Alexander Schallenberg, në një konferencë për media në Vjenë. Nga 16 qershori, Austria do të mirëpresë udhëtarë nga 31 vende pa kufizime. Përfundime janë Suedia, Spanja, Portugalia dhe Mbretëria e Bashkuar, tha Schallenberg. Udhëtarët nga këto vende do të

duhet të kenë test negativ për koronavirus ose t'i nënshtrohen karantinës për dy javë. Suedia është në listë për shkak të rritjes së shpejtë të numrit të të infektuarve me koronavirus në ditët e fundit, tha ministri austriak i Shëndetësisë, Rudolf Anschober. Sipas tij, edhe Portugalia ka numër në rritje të rasteve, ndërsa Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar janë në mesin e vendeve me numrin më të lartë të të infektuarve.



## BE-ja kërkon më shumë llogari nga gjigantët e internetit për lajmet e rreme



BRUKSEL, 10 QERSHOR - Zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian u bënë thirrje platformave sociale, si "Facebook", "Twitter" e "Google", që t'i rrisin përpjekjet për t'i trajtuar dezinformatat në lidhje me koronavirusin. Nënpresidentja e Komisionit Evropian, Vera Jourova, ka kërkuar nga gjigantët e internetit që të ofrojnë raporte mujore për mënyrën se si po i frenojnë lajmet e rreme dhe përpjekjet e grupeve të huaja për t'i dobësuar masat e shën-

detit në Evropë. "Dezinformimi nuk dëmton vetëm shëndetin e demokracive tona, por edhe shëndetin e qytetarëve tanë", ka thënë ajo në një konferencë për media në Bruksel. Komisioni këmbëngul se "aktorët e huaj dhe disa vende të treta, veçanërisht Rusia dhe Kina, janë angazhuar në operacione dhe fushata dezinformuese në BE", ka pohuar Jourova, por pa dhënë më shumë detaje. Bashkimi Evropian disa herë ka

paralajmëruar për përpjekjet e aktorëve të huaj, sidomos Rusisë dhe Kinës, për të ndikuar te qytetarët përmes fushatave të dezinformimit. Jourova i vlerësoi gjigantët digjitalë amerikanë që kanë rënë dakord për një kontroll shtesë, që synon ta ndalojë përhapjen e dezinformatave të lidhura me koronavirusin, por tha se ky është vetëm hapi i parë dhe se "ka hapësirë për përmirësim". "Ata duhet të ofrojnë më shumë prova se masat që kanë marrë janë duke funksionuar", tha Jourova.

## Kina refuzon pjesëmarrjen në diskutimet për kontrollin e armëve

PEKIN, 10 QERSHOR - Kina është duke refuzuar pjesëmarrjen në bisedimeve për kontrollin e armëve. Shtetet e Bashkuara kanë shpresuar që Rusia do të mund ta bindë Kinën për t'iu bashkëngjitur negociatave për kufizim të rezervave bërthamore në të tria këto

shtete. Shtetet e Bashkuara janë larguar së fundmi nga disa traktate ndërkombëtare për kontrollin e armëve, duke kërkuar përfshirjen e Kinës në diskutimet e reja. Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme të Kinës, Hua Chunying, ka thënë se Pekini ka

treguar edhe më herët se nuk do të jetë pjesë e bisedimeve trepalëshe. "Ne kemi vërejtur se ShBA-ja ka shtyrë Kinën në këtë çështje... pavarësisht se kur ngritet", me qëllim të ikjes nga përgjegjësia që ka", ka thënë Hua. Pretendimet e Uashingtonit se

dëshiron të negociojë në mirëbesim "janë tejet qesharake dhe as nuk tingëllojnë si të vërteta", ka thënë ajo.



# 10 vjet pa Bekim Fehmiun, “DukuFest” shfaq film në kujtim të aktorit

Në shenjë kujtimi me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta të aktorit të njohur Bekim Fehmiut, DokuFest shfaq filmin “Mbledhësit e Puplave”, shkruan KultPlus

Kjo ngjarje do të organizohet në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, është pa pagesë si dhe

konform rregullave për distancim social, thuhet në njoftimin e tyre në Facebook.

**Njoftimin e plotë:**

“Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se me rastin e 10 vjetorit të ndarjes nga jeta e aktorit të njohur të filmit dhe teatrit Bekim Fehmiu, do të shfaqim filmin e Aleksandar

Petrovic ‘Mbledhësit e Puplave’ fitues i çmimit Grand Prix në festivalin Cannes, 1967.

Me Bekim Fehmiun si protagonistin kryesor, filmi shpalos tensionet e një komuniteti rom ku një shitës lokal i puplave dashurohet me një vajzë shumë më të re në moshë. ‘Mbledhësit e Puplave’ do

shfaqet të hënën me 15 qershor në KEJ, përballë lidhjes së Prizrenit duke filluar nga ora 7 e mbrëmjes. Ceremonia do të nisë me hedhjen e luleve në Lumbardhin e Prizrenit – si shenjë nderimi ndaj figurës së aktorit të shquar i cili la gjurmë të përjetshme në kinematografinë vendore dhe botërore – dhe do të

pasohet nga aktori Xhevdet Doda i cili do të lexojë disa fragmente nga libri ‘E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme’ i Bekim Fehmiut.

Ngjarja organizohet në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, ofrohet pa pagesë dhe do zhvillohet konform rregullave të distancimit social”.



## Pse duhet rilexuar ‘Iliada’?

**Nga: Mauro BONAZZI**

Një epidemi e padeshifrueshme; shumë të vdekur; dhe vendime të vështira për t’u marrë. Kështu fillon “Iliada”, teksti i parë letrar i qytetërimit evropian. Agamemnoni, mbreti i ekspeditës ushtarake të grekëve kundër Trojës, kishte marrë si plaçkë lufte bijën e një prifti – Kriseidën. Dhe, prifti Krise i ishte lutur Zotit të tij që ta ndihmonte, kur mbreti Agamemnon kishte refuzuar që ta rikthente. U tha, u bë! Agamemnoni kishte guxuar të fyente një Perëndi? Apollo e kishte ndëshkuar menjëherë, duke lëshuar në vendfushimin e ushtrisë greke shigjetat e tij të helmatisura “Murtaja e ligë pllakosi në fushë”, “Nuk ndaleshin zjarret në turrat e druve ku digjeshin të vdekurit”. Vetëm nëse dorëzonte Kriseidën, do t’i shpjegonte Kalkanti, perëndia do të qetësohej. Është momenti kur shpërthen problemi i Iliadës.

Kriseida ishte robinjë e Agamemnonit: duke privuar veten nga ajo, ai do të kishte më pak se luftëtarët e tjerë. Dhe, kjo ishte e papranueshme. Si të bëhej? Sigurisht që vajza duhej të kthehej te babai i saj. Po Agamemnoni?

Janë histori aktuale, nëse kupton skemën mbi të cilën janë ndërtuar. Rrëfimi artikulohet në fakt përgjatë dy linjave, njëra vertikale dhe tjetra horizontale, si dhe dy koncepteve mbi drejtësinë. Linja vertikale ka të bëjë me marrëdhënien mes njerëzve dhe perëndive; ajo horizontale ka të bëjë me marrëdhënien mes vetë njerëzve. Është drejtësia hyjnore, ndëshkimi që pashmangshmërisht godet qeniet njerëzore kur shkelin kufijtë që u janë vendosur; dhe një drejtësi njerëzore që ka të bëjë me mënyrën se si njerëzit organizojnë marrëdhëniet e tyre reciproke. Ngajnë si dy çështje të ndryshme: krejt papritur zbulohet se janë ngushtësisht të



ndërthurura mes tyre. Si mund të organizohet në mënyrë të barabartë bota e njerëzve, pa bërë padrejtësi kundrejt perëndive? Mjaft të ndryshosh krahët e natyrës, dhe problemet e Agamemnonit bëhen edhe tonat.

Përdhosja e natyrës ka një çmim që herët a vonë na duhet ta paguajmë. Ashtu si heronjtë homerianë, edhe ne shpresonim që të zgjidhnim problemet tona, të organizonim botën tonë duke shfrytëzuar realitetin që na rrethon. Nuk mundet. Ashtu si

Apollo, edhe natyra herët a vonë do të reagojë – dhe neve nuk na mbetet veçse të gjuhëzohemi: nuk debatohet me këto fuqi superiore.

Është një ide që përsëritet vazhdimisht këto kohë, teksa virusi përshkon globin. Shfrytëzimi intensiv i burimeve natyrore po shkakton tronditje: është e domosdoshme të dëgjojmë natyrën dhe të ndryshojmë mënyrën tonë të jetuarit, duke mësuar më në fund të pranojmë se nuk jemi zotër të botës. E vërtetë, por

mësimi i “Iliadës” është një tjetër: problemi më urgjent nuk është marrëdhënia me mjedisin që na rrethon. Problemi është si të organizojmë botën tonë. Burimet janë të kufizuara: duhet të konsumojmë më pak, apo jo. Po konkretisht? Kush dhe si duhet të heqë dorë nga pjesa e vet? Përse kush ka, duhet të japë? Pra, si duhet të vazhdojmë? Për këtë duhet të flasim, siç e shpjegon Nestori, shumë këngë më vonë tek Iliada: pasi shumë heronj dhe shumë më tepër ushtarë të thjeshtë, kanë rënë në betejë. A nuk mund të gjendej një zgjidhje më herët?

Problemi mjedisor është një problem drejtësie politike. Homeri është një mjeshtër, nuk pëlqen të japë leksione. Duke u njohur dobësitë, ai i do të gjithë personazhet e tij, pa bërë dallime. Po të ishte këtu sot, do të mbështeste të gjithë ne, me shpresën që do ia dalim të sillemi me pakëz më shumë inteligjencë, se sa heronjtë e tij. /Burimi: Sette/Në shqip: Bota.al/

**E rrallë**

## Ura në "qiel"

Është e lehtë ta kuptosh pse "Kristali" është një nga atraksionet më interesante në Kinë. Objekti magjepsës është i projektuar nga Moshe Safdie dhe njihet si "ura në qiel" me lartësi 250 metra. E njohur si ndërtesë horizontale, ajo shtrihet përgjatë 350 metrave në tetë objekte të tjera, që plotëson kompleksin "Raffles City Chongqing", e cila gjendet buzë lumit në Kinën jugperëndimore.



**FOTO E DITES**



Një punëtor mjekësor shihet duke ia bërë një mostër një banori në Kinë për testim për Covid-19. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

## I gjithë fshati suedez në shitje për 7 milionë dollarë

Nëse i keni 7 milionë dollarë, ju tashmë keni një mundësi të rrallë të blini një fshat të tërë. I ndërtuar në shekullin e 18-të si vendpushim shëndetësor, Swtra Brunn është një shembull i përsosur i arkitekturës së fshatit suedez, i përbërë nga një kishë, një shkollë dhe një hotel.



Ky fshat është mbajtur në një gjendje mjaft të mirë për më shumë se 30 vjet nga disa banorë. Dhe tani ata mendojnë se ka ardhur koha që për këtë fshat të kujdeset dikush tjetër.

**BARSOLETA E DITËS**



Një grua po i ankohej mjekut:  
 - Djali im është mjaft i sëmurë. Ka dhimbje të forta në bark.  
 - Çfarë ka ngrënë?  
 - Njëfarë fiqi tha, e ai ishte i mbushur me miza.  
 - Jepi ilaç mizash dhe qetësohet.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 18:00  
Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



**Në ora 18:00  
Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



**Çdo natë në ora 20:00  
STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams



**Çdo natë në ora 22:30  
THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Të lindurit e kësaj shenje do të kuptojnë se është koha e duhur për ta rritur nivelin e profesionalizmit.</p>	 <p><b>DEMI</b> Nuk rekomandohet të bisedoni gjerësisht me persona që sapo i keni njohur. Bisedat intime, historitë, jeta personale apo arritjet tuaja nuk janë të mirëpritura.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Ditë e ngarkuar. Pasiviteti nuk do të jetë i mirëpritur nëse dëshironi të fokusoheni në suksesin profesional apo konkurrencën me kolegët.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> E nisni shumë mirë. Tregohuni më të thjeshtë gjatë bisedave, pasi kështu do të jeni më efektiv.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot duhet të nxitoheni për të zgjidhur disa çështje profesionale. Ndoshta duhet të merrni shembull nga individë të suksesshëm.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Bëni të pamundurën për ta shmangur pesimizmin, pasi kjo mund t'ju sjellë dështim në fusha ku ju po përpiqeni maksimalisht.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Ka gjasa që nesër të përballeni me disa konflikte, ndaj duhet të tregoni shumë me takt me veprimet.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Teksa kërkoni të shënoni gjithnjë e më shumë fitore, mos harroni se jeni qenie njerëzore dhe jo robot.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Të lindurit e kësaj shenje nuk duhet të reagojnë ndaj provokimeve me të cilat mund të përballen gjatë kësaj të mërkure.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Shmangni kontaktet me persona që janë aktualisht në një marrëdhënie romantike. Kushtojini më shumë punës, pasi ekziston mundësia të rriteni në pozicion.</p>	 <p><b>UJORI</b> Do të kaloni një ditë të qenë gjatë së cilës do të keni edhe mundësi për t'u relaksuar. Nuk parashikohen probleme si në anën profesionale ashtu edhe në atë personale.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot do të mbeteni nën hijen e dikujt që është më i vendosur se ju. Ndoshta një situatë e tillë do të ndodhë në punë.</p>

## Georgina shfaq këmbët seksi në fustan të shkurtër



**G**eorgina pozoi tërheqëse në imazhin e ri. Georgina Rodriguez vazhdon ta marrë vëmendjen e të gjithëve me paraqitjet joshëse. Partnerja e Ronaldos së fundi publikoi një fotografi, ku shfaqet e veshur me një fustan të shkurtër të zi, ndërsa sipër kishte veshur një këmbishë të bardhë. Ajo dukej elegante teksa

vuri në plan të parë këmbët seksi e ulur pranë pianos, ndërsa realizoi selfie tërheqëse. Georgina së fundi është komentuar shumë për fizikun, teksa po tregon format trupore nga palestra. Georgina Rodriguez bashkë me Cristiano Ronaldon dhe fëmijët muajt e fundit kanë qëndruar të vetizoluara në Itali.

## Justin dhe Hailey, pas izolimit në shtëpi, fillojnë pushimet



**A**ta kohët e fundit u nisën për në një udhëtim luksoz në një park kombëtar në Utah, duke udhëtuar me shumë stil me një automjet ekstravagant që besohet se kushton mbi një milion dollarë. Por, të shtunën, Justin Bieber dhe gruaja e tij, Hailey Bieber, u panë duke u rikthyer në natyrë, pasi u zhveshën në rroba banje në një liqen, duke shijuar disa çaste intime së bashku.

Hailey, 23-vjeçare, tregoi fizikun e saj në mënyrë mbresëlënëse në bikini me ngjyrë të gjelbër, ndërsa Justin, 26 vjeç, shfaqti tatuazhet e tij duke veshur një palë pantallona të shkurtër. Utah është e njohur për liqenet, përrnajtë dhe lumenjtë e saj të mëdhenj dhe duket sikur çifti gjeti vendin e përsosur për t'u relaksuar pas izolimit në shtëpi nga Covid-19.



## Mbaron karantina për Sara Hoxhën dhe Ledrin

**L**edri Vula dhe Sara Hoxha janë një nga çiftet më të komentuar të ekranit. Pak kohë më parë ishte reperi ai që konfirmoi lidhjen me Sarën, që përflitej prej disa kohësh. Së fundmi, pas disa muajsh të ndarë për shkak të pandemisë, Ledri dhe Sara janë bashkuar dhe kanë vendosur ta shijojnë detin dhe rrezet e diellit. Ka

qenë Sara ajo që ka ndarë disa foto pranë reperit në plazh. "Kjo më bën kaq të lumtur tani", ka shkruar Sara në rrjetet sociale duke iu referuar plazhit, diellit dhe sigurisht pranisë së Ledrit. Duket se çifti po kalon ditët më të bukura të lidhjes, madje flitet se kanë vendosur të marrin hapa më seriozë në marrëdhënien e tyre.

## Vdes këngëtarja e grupit amerikan R'n'B "Pointer Sisters"



**B**oni Pointer, një nga katër motrat e grupit amerikan pop dhe R'n'B "Pointer Sisters", ka vdekur në moshën 69-vjeçare. Shkaku i vdekjes janë problemet me zemër. Ajo lindi më 11 korrik 1950, në Ouklend të Kalifornisë në ShBA. Boni, Anita

dhe Xhun, para se të bëheshin të famshme në vitet 1970, kanë kënduar së bashku në kishën e babait të tyre në vendlindjen e tyre. Ata kanë fituar tre çmime Gremi, përfshirë një për këngën e "Fairytale" të vitit 1975, të shkruar nga Boni dhe Anita.



## Roland Dasho, Skënderbeu i vogël i filmit

### Intervistoi: Xhevair LLESHI

*Kur u zbulove që je ti Skënderbeu i vogël i filmit?*

R. D. – (Qesh) Në shikim të parë ashtu duket, sikur jam vetëzbuluar, por unë këtu kam qenë, në punë, në shtëpi, me shoqërinë, njerëzit e mi, me kujtimet. Po edhe me facebook-un, të cilit hera-herës i hedh një sy. Ja ky u bë shkaku. Lexova një ditë se Kom Nova dhe Shaban Polovina, beratas natyrisht, kishin qenë figurantë në filmin «Skënderbeu» si shumë të tjerë. Edhe imë 'më ka qenë një nga valltaret në dasmën e Skënderbeut, që u luajt në sheshin e kishës së Drobonikut në Berat. Ime 'më u bë shkak, se më merrte në sheshet e xhirimit. Isha klasa e parë në fillore... Dhe thashë, pse të mos e shkruaj edhe unë në facebook? E shkrova dhe kaq. Më pas e hase ti dhe bëre atë që di më mirë, e shkrove. Dhe ajo bëri bujë...

*Ç'skena janë luajtur në Berat të ky film?*

R. D. – Nga koha e xhirimeve mbaj mend veten kur më hipën në kalë. Kisha shumë frikë. Por ajo që shoh në film më bind se e kam tejkaluar frikën. Është zgjuar madje një lloj krenarie. Por skenat në film të luajtura në Berat janë të shumta, sidomos në Kala dhe në Drobonik, në Ullishtë... Në një farë mënyre filmi u hakmor nga *Betejës së humbur të Beratit*, një nga të vetmet e humbura, sepse thjesht i besoi pritjes, sinqeritetit, kurse triumfoi dhelperia e ndryrë

osmane, duke dërguar lajmës të fshehtë nga shkëmbi Çekbeni i Kalasë...

*Sa mendon se të qenit i pranishëm në filmin Skënderbeu ka luajtur rol në jetën tënde?*

R. D. – Për mua aq mbetet. E them në një kuptim simbolik. Si të thuash më ka mbushur si motiv dhe ka hequr një fill të pakuptueshëm të brendshëm gjatë gjithë viteve të shkollimit, studimeve dhe të punës, kurdoherë. Jo se mbaja portretin e Tij para syve, por portretin e kisha së brendshmi, udhëheqës që më nxiste: duhej patjetër të isha i pari (jo i dyti, se e ka lënë Enco Ferrari në librin e tij, që i dyti është i pari i humbësve!). Dhe kjo moto ma ka shpërblyer. Jetoj bashkë me mua. Madje edhe tek fëmijët e mi e më tej...

*Po ç'je ti, Roland, në fakt?*

R. D. – Unë jam djali i vogël i filmit «Skënderbeu» që dërgohet peng te sulltani. Gjergji i vogël, Gjergj Kastrioti Skënderbeu i ardhshëm, mbreti i shqiptarëve që do të spikatej me zulmë të madhe, luftëtari dhe diplomati habitës, njeriu që i dha famë shqiptarëve dhe luftës së tyre kundër Perandorisë Osmane....

*A i mjaftojnë çdo njeriu ato pak çaste të mbetura në film?*

R. D. – Kjo është vetëm një sekuençë që i jep tjetër kredit personalitetit të një njeriu të mësuar, të shkathët intelektualisht, i jep zë të veçantë dhe kur të mos jetë më do kërkojnë të dinë më shumë për Rolandin, jo thjesht si një student i zoti i biokimisë, as edhe si profesion-

ist dhe as si një njeri që di t'i organizojë mirë punët që bën. Po vetëm për këto tri-katër minuta, pa e ditur sheshpushimin dhe sheshveprimin e filmit, pa ditur rrethanat që më çuan deri te filmi, derisa regjisori i vuri vulë. Çdo njeriu i mjaftojnë ato pak çaste të mbetura në film, me kulmin e emocionit të përfutur. E vërteta është se ai çast magjik, sidomos pse je fëmijë,



bëhet nxitje e papërfytyrueshme për tërë jetën, por gjithashtu sot është një tjetër dritare për t'u parë krejt ndryshe. Ndryshe në çdo hap. Po pse jo edhe për të mbetur trashëgim, edhe si pasuri. Se, fundja nuk është filmi «Dhe vjen një ditë...», sigurisht pa ia mohuar rëndësinë...

*Ç'fëmijë ke qenë ti Roland?*

R. D. – Isha thjesht i vogël, fëmijë, i shënjuar nga fati pse jo, djalë i rrëmujshëm dhe i përkëdhelur, që do të mbetesha përjetë në celuloid, duke sjellë diçka madhore në kujtesën kombëtare, do të isha për këdo djali i fundit i Gjon Kastriotit dhe do të merrej peng nga sulltani. Kur e

vështrojmë në sy të vërtetën e tmerrshme të asaj kohe, barbarizmin dhe energjinë e saj, atëherë mund ta ndiejmë edhe më thellë emocionin që vilet edhe sot e çdo kohë.

*Dhe i ke bërë një përgjithësim filozofik atij çasti magjik?*

R. D. – Po, por ama një filozofi timen. Në raste të tilla kushdo mund t'ia vërë fajin jetës, madje

*E ke të fiksuar vendin ku ka qenë sheshxhirimi?*

R.D. – Ata që jetojnë në lagjen «Kala» të Beratit e dinë ku është kisha e Onufrit, katedralja e Shën Mërisë, ose muzeu i veprave të tij, Muzeu kombëtar «Onufri», e njohin sheshin para tij edhe sikur të ndodhen në situata të papërshtatshme, madje edhe në grahamat e fundit të jetës...

*A ke meditar ndonjëherë për situatën filmike?*

R.D. – Besoj që shumë herë. Se dihet që fëmijët nuk u shpëtojnë dot «së tyre», pjesës më interesante, sado që ne shpesh na pëlqen të themi «të mësuarës». E mësuarja është aty, sigurisht, por e tretur brenda kuptimit që i jepte ky djalë i vogël i filmit (do të thotë edhe Roland Dasho), derisa më në fund regjisori të kënaqej me veprimin, zërin, sjelljen, lëvizjet, si ta hipnin mbi kalë për të kalëruar me një «osman» drejt zemrës së Perandorisë së madhe, aty ku ishin denjërit, aty ku ai (unë, gjoja) do mësonte forcën dhe kulturën, gjuhët, diplomacinë, por që, siç e dimë do të mbetej shqiptari më i madh i të gjitha kohërave! Sido-sido kjo më gicilon sapak...

*Si thua, rrugicat e Kalasë së Beratit krenohen me episodet e fimit?*

R.D. – Rrugicat e kalasë së Beratit, e di që krenohn me episodet e filmit «Skënderbeu», pasi ato dhe eleganca e tyre e përsosur janë lënda e gatshme mesjetare që i dhurohet filmit. Aty hidhej sera, uji i vluar, aty ngriheshin shkallët dhe para mureve zhvilloheshin betejat e mëdha të historisë sonë.



Por rrugicat dhe muret nuk kanë gojë të tregojnë. Rrugicat dhe muret e heshtur janë e do të jenë aty me një pëshpërimë plot dall-di, se ato kanë qenë dikur, pa dashjen e tyre, natyrisht, sfida e madhe e Skënderbeut, zulma e tij, pse jo edhe turpi i madh, helmi dhe thika pas shpine, fusha e mbjellë me të vranë (vetëm ullinj të janë dëshmitarët e historisë)... Por ja që edhe e hidhura e madhe kthehet në mjaltë. Vetë Kalaja e Beratit mori hak për vete, derisa e bindi me një thjeshtësi të madhe regjisorin që aty të zhvillohej veprimi, pa e ditur ndoshta historinë, veç t'ia kenë treguar aktorët shqiptarë gjatë ndenjjes në sheshpushim...

*A ke ndonjë mendim për karakterin në film?*

R.D. – Dikush do të thoshte se karaktereve njerëzore që vepronin në film këto rrugica u kanë dhënë fisnikëri dhe kjo ka mbetur përgjithnjë në imazhin e filmit. Aq më tepër që filmit i intereson sidomos karakteri. Këta i kemi në të përditshmen tonë, me ta mund të përhëndemi, siç ndodh fjala vjen me mua, si për ta bërë sot krahasimin me kureshtje të fortë jo vetëm për t'ua rrëfyer njerëzve. Por, megjithatë, kjo është edhe



histori argëtuese, e tillë edhe për vetë personazhin, ndonëse e veshur me petk interesant dhe të jashtëzakonshëm, që mbart me kujdes tharmin «e kohës», shoqëruar me fytyrën e ashpër (luftëtarët), naivitetin, sjelljen e zakonshme e shoqëruar me virtytin e rrallë që fal me vull të përtshme magjia e kinemasë...

*Si e imagjinon ngjarjen kur ke luajtur rolin e famshëm që fati ta dha?*

R.D. – (Qesh)Hm. Rolandi i vogël luante rreth e rrotull këmbëve të aktorëve, nuk përmbahej në kënaqësinë e vet, se aq shumë njerëz nuk kishte parë ndonjëherë, aq shumë kostume popullore, aq shumë ngjyra, aq shumë skena, aq mrekulli që i binin nga qielli. Aty shtroheshin dreka e darka, aty kishte shumë verë, pihej e këndohej, aty luhej luftash, vrapohej, kishte aq shumë kuaj të bukur sa ai vogëlush (qesh si nën buzë) kishte parë kurrë në jetë. Një botë e mrekullueshme. Regjitori do ta ketë parë në prehrin e së ëmës dhe do të ketë bërë titull «E gjeta Skënderbeun e vogël! Është i mrekullueshëm!» Mamit, domethënë së ëmës së Rolandit do t'i ketë rënë atë çast një nur tjetër, siç u bie zakonisht

nënave kur flitet për bijtë e tyre. Por regjitori mund ta ketë pikasur edhe në sheshe duke luajtur, duke mbledhur ndonjë lule, duke e parë në sy fytyrën e mahnitur nga lëvizjet e dendura të «luftëtarëve», me aq shumë armë, klithma dhe vrapime saqë do ta ketë pasur të vështirë të mos habitej. Atëherë regjitori do ta ketë ngritur në krahë, duke e çuar lart, rrahur nga rrezet e diellit. Se fytyra e kujt do vogëlushi të mahnit, dihet. Ai sikur të vinte nga thellësia e historisë do të mbinte aty në sheshxhirim si djali i fatit të plakur, si biri i një komiti të pamësuar me atë çfarë ndodhte rreth e qark. Ai më mirë se çfarëdo tjetër mund të bënte vrima në tokë me një copë dru, mund të imitonte një makinë, një kalë, një shpatë. Ta filmoje lëvizjen ditore, veprimet dhe habitin e tij të jashtëzakonshme, kjo kishte për të qenë një magji më vete... Një magji dhe shkollë për ata që studiojnë psikologji. Jam i bindur se kushdo që do ta shilte kështu vëmendjen e kamerës do të mahnitej me këtë sy regjisorial...

*M'u duke e frymëzuar. Pse?*

R.D. – Kujtesën, frymëzimin dhe imagjinatën m'i ka dhënë dhe forcuar mëma, duke ma nanuritur si rrëfime të vjetër, pse

jo edhe si përrallë të bukur...

*Ta ka përmendur kush këtë fakt, në CV, apo e ke pasur si kalë belaje?*

R.D. – Një shenjë kaq e bukur dhe sigurisht emocionuese, nuk mbetet në harresë. Po edhe unë, nuk se protestova ndonjëherë që nuk ma përmendnin këtë fakt dominues, të cilin do të doja shumë t'ma zinin ngoje, sigurisht nuk kundërshtova askënd, i ndershem në kumtin e ditës, rrethuar me heshtje të ftohtë, ndërsa zemrën – sikur më thërriste – ma linin të paktën t'më rrihte në kraharor. Nuk mund ta kërkoj famën, por sido nuk kam harruar gjë, mbeta gjithnjë stoik, nuk kërkoja të merrem me letrat vetëm se më pëlqen fort letërsia, u hedh parfumin e filmit tregimeve dhe poezive që lexoj dhe mbaj për vete një dhimbje të bukur...

*M'u duk se doje të shtoje diçka, apo...?*

R.D. – E pra, unë jam nga Berati, më pëlqen që mbeta «Skënderbeu i vogël i filmit». Kam si shenjë filmin e madh «Skënderbeu», film që e bëri aq të njohur Shqipërinë, më solli edhe mua fat të paparashikueshëm,

sepse u lidha pazgjidhshëmrisht me Beratin, qytetin tim dhe e kuptova se edhe Berati fitoi aq shumë nga ai film i madh. Por e fshehta mbeti magji për Beratin, ashtu edhe për mua.

*E ke menduar ndonjëherë po të mos kishte qenë filmi «Skënderbeu»...?*

R.D. – E çfarë pastaj po të mos ishte filmi «Skënderbeu»? Unë njëlloj do të vija si një mysafir i vonuar, do ta ndieja njëlloj frymën e ngrohtë të të tjerëve, se njeriut i ka lezet jeta pasi është bashkë me të tjerët Jo si tani me Coronavirusin. Do të guxoja në mendt e mia të isha pjesë e një filmi? Kurrë, sepse nuk u bëra dot ajo që më kaploi atëherë dhe në atë moshë. Kjo më duket e prekshme, pse jo edhe e besueshme! Nganjëherë them se shaka të tilla janë të bukura. Them po ashtu se sikur të isha unë Gjergji i vogël... Dridhem me një rrëmujë të pazakontë mendimesh dhe nuk e besoj se do të bëja dot atë vepër aq të madhe! Eh, të madhe! Dhe kjo ma fut më tej ngasjen, më bën të qesh e ta sulmoj veten time ashtu siç di unë, mbarë e prapë...

*Fëmija edhe kur s'ka mundësi filmi, për shembull, përsëri është i dashur. Si mendon?*

R.D. – Fëmija kurrë nuk mendon gjatë. Tmerri i fëmijës është kur sjell ndërmend se mund të mos i ketë më prindërit e tij, por jo, sigurisht jo të luajë në zgjatimin e thekshëm të kohës, të qëmtojë me sy atë që i mungon, t'i pëlqejë edhe ato që brenda gjërave të zakonshme janë fare të mërzi-shme. Fëmija nuk ka shpella në mendjen e vet, as bën plane, thjesht fëmija edhe kur s'ka asnjë mundësi është i dashur. E ka bërë perëndia të tillë, të gjejë të domosdoshmen më të hollë, më të bukur, siç e krijoi Grabovi i madh, më të përshtatshme edhe kur është në humbëtitat më të harruara, edhe kur endet në prehrin e kotësisë, edhe kur jeta e zhyt në gjanën e banalitetit, edhe kur është tronditur aq thellë jeta e tij e krisur...

*Mos është një ndjenjë që përfundon si shaka?*

R.D. – Kështu do të më pëlqente ta rigjeja edhe njëherë fëmijërinë time, paçka se ato tri-katër minuta, ajo sekuencë e përgatitjes me aq mundim e thjeshtësi më detyron shpesh që të vë buzën në gaz. Ne, sigurisht, i pëlqejmë gjërat e mira e të bukura pasi kanë kaluar, sepse habia e kohës së vërtetë nuk na lë rehat, na shtyn ose na tërheq, na detyron nganjëherë ta mendojmë ndryshe, si një sprovë e dësh-tuar, edhe pse imitimi na rrëmben. Mahnia e fëmijës: të bëjë sikur! Detajet (ah sikur të m'i gjenit ato, sa mirë do të qel!), do të kenë qenë shprehëse, paksa të çuditshme, do të më kenë zënë në befasi, mbushur plot pandehma e sekrete (sekretet e asaj moshe janë një tjetër mrekulli dhe duhet thënë se më i forti është pikërisht ai që mbart sekrete të mëdha!), një sugjestion i çmendur, edhe pse ia beh aq shpejt e shpejt sikur të ishte thjesht një



Roland Dasho para përkrenares së Skënderbeut (ardhur nga Vjena)

tronditje dhe aq, një ndjenjë që përfundon si shaka...

*Egoizmi i fëmijës...më duket ruan një batutë për të?*

R.D. – Po, po ta them: s'ka gjë më bukur se sa egoizmi i fëmijës! E ka gdhendur ime me në shënimet e filmit. Dhe më mbeti. Do të doja ta rijetoja, Zot i madh, dhe kudo të prezantoja as më pak e as më shumë veten time, që shpesh duket si aureolë mbrojtëse, bëhet pastaj edhe metaforë... Mendo, egoizmi fle mes ëndrrash, me siguri matematike – tejet të zmadhuara, se ndryshe nuk shkojnë, s'kanë pikë shijeje. Mendo, sikur të mos e kisha Skënderbeun në atë skenë të paharrueshme a do të kisha mbetur pa ëndrra dhe a do të ndihesha i mposhtur nga fati? S'e di, as e kam menduar ndonjëherë, por ama e di egoizmin e fëmijërisë sime, atëherë kur bëja diçka për t'u plakur, kur punoja rrengje, kur dëshiroja vetëm të bëja po atë jetë që bëja, të ngrija në këmbë entuziazmin e magjishëm të moshës, dhe t'ua tregoja plot mburrje të gjithëve se çfarë kisha bërë, domethënë atë që nuk bëja dot kur u rrita...

*Ç' të ka mbetur nga ai vit i largët, kur luhej në Berat filmi «Skënderbeu»?*


R.D. – Ndoshta pak trishtim, po aq edhe mërzi, ildisur me një shaka të kërthndezur, e jerasitur si keqardhje, e pra, pak jetë. Mbaron filmi, pastaj fillon loja, arratisur nga e vërteta. Të vërtetat që pa dashjen tonë na injektoshin në gjak. Një rreth vicioz gjërash ku mbytemi nga pak për ditë, po edhe lumtur-hemi përditë, të heshtur dhe të mahnitur se si na rrodhi koha kaq shpejt e pa kuptuar...

*Me sa di po përgatitet filmi dokumentar për xhirimet e filmit «Skënderbeu» në Berat?*

R.D. – Ah sikur të ndodhë! Sa do të kisha dashur të isha takuar ndonjëherë me ata që luajtën filmin «Skënderbeu», do të doja që ishim edhe njëherë në sheshet brenda kalasë dhe të përcillja emocionin e asaj kohe të papërsëritshme. Nuk paskam qenë as atëherë i qetë, siç nuk u ndjeva kurrë në jetë, duke ecur në jetën time pa thekse të mëdha e pa bëma të atilla që të thosha se më shkonin, se po ecja edhe unë nëpër maja... Kjo, pikërisht kjo mbeti e fshehta ime, po në një farë mënyre edhe rreziku im – sepse më duhej të ktheja gjithnjë kokën prapa, pasi i prishja baraspeshat e çmendura dhe njëherazi të shenjtëruara. A thua se e kuptova ndonjëherë kotësinë e atypëratyshme të çastit? Kurrë! Çasti të kredh brenda pa u ndierë, pa u kuptuar, ashtu siç edhe të rrëmben, të bën për vete, si nën një furi të papërbalueshme, si pasion që dikur do të vinte dhe unë do të bëhesha zot i vetvetes. Dhe i pari për mua do të mbetej emocioni... A do të ndihesha paksa keq kur t'i hipja tani, kalit të Skënderbeut? Por kjo s'mund të ndodhte se ishte kush t'më mbante në prehër...

*A të duket e gjithë kjo si një metaforë?*

R.D. – Metafora mbeti e fshehur brenda jetës sime. Emocioni doli sheshit, jelekzberthyer dhe si djalos që të prish mendjen duke pasur nën vete një butafori sëkëllidëse, mahitur me diçka krejt njerëzore e të vdekshme, në kulmin e gjërave të bukura që kam dëshiruar të bëj. Gjithçka sikur ndodh sa për t'u marrë me mend, si një mërzi e bukur që s'kthehet kurrë më. Dhe mbeta rob i atij çasti: Skënderbeu i vogël i filmit... (Marrë nga Exlibris)



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Dabiqaj: Ndaj Ballkanit kemi mundur të marrim rezultat më të favorshëm

Albert Dabiqaj ka thënë për "Epokën e re" se Feronikeli ka mundur të marrë rezultat më të mirë në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Kupës ndaj Ballkanit (0-0). "Normalisht se jemi të kënaqur me dy ndeshjet e para. Kemi pasur paraqitje të mirë dhe kemi mundur të marrim rezultat më të favorshëm ndaj Ballkanit, por në ndeshjen kthyesë luajmë në fushën tonë dhe kemi gjasa të mëdha që të kualifikohem tutje në garën e Kupës", ka thënë Dabiqaj



pasi aktualisht ka nëntë pikë më pak se skuadra kryesuese, Drita e Gjilanit. Lidhur me mbrojtjen e titullit të kampionit, Dabiqaj ka deklaruar: "Kemi mbetur shumë pikë mbas, por të shohim çka mund të bëjmë". "Nikli" është në pozitën e pestë me 347 pikë, por synim kryesor në këtë edicion e ka triumfin në garën e Kupës dhe pjesëmarrjen në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës.

**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Skuadra e Feronikelit ka nisur mirë pas pushimit të detyruar për shkak të pandemisë Covid-19, pasi në dy ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar një barazim dhe një fitore. Skuadra që drejtohet nga Afrim Tovërlani barazoi me Ballkanin në gjysmëfinalen e parë të Digitalb Kupës (0-0) dhe e ka mundësinë

që të kualifikohet në finale për faktin se në ndeshjen kthyesë luan në Drenas, kurse në ndeshjen për kampionat e mposhti Vushtrinë (3-1).

Mesfushori Albert Dabiqaj ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se "Nikli" ka startuar mirë anipse në ndeshjen kundër Ballkanit ka mundur të marrë rezultat edhe më pozitiv. "Normalisht se jemi të kënaqur me dy ndeshjet e para. Kemi pasur paraqitje të mirë dhe

kemi mundur të marrim rezultat më të favorshëm ndaj Ballkanit, por ndeshjen kthyesë luajmë në fushën tonë dhe kemi gjasa të mëdha që të kualifikohem tutje në garën e Kupës", ka thënë Dabiqaj. Ndeshjen e radhës skuadra e Feronikelit e zhvillon nesër (e premte) ndaj Dukagjinit. Mesfushori Dabiqaj ka

konfirmuar se në Klinë kërkojnë tri pikët e plota. "Kundërshtari i radhës është në pozitën e fundit, por ka një skuadër të mirë. Ne shkojmë për fitore dhe besoj se do t'ia arrijmë këtij qëllimi", ka shtuar ai. Skuadra kampione në fuqi e Kosovës në këtë edicion ka mbetur pas në garën për titull,

**IPKO SUPERLIGA - JAVA E 24-T**

**Të premten takohen:**  
17:00 Dukagjini - Feronikeli  
17:00 Flamurtari - Ballkani

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Vushtrria - Prishtina  
17:00 Llapi - Drenica

**Të dielën takohen:**  
17:00 Trepça '89 - Drita  
17:00 Ferizaj - Gjilani

## UEFA Champions League 2021-2024 ekskluzivisht në "Armtmotion"

"Armtmotion" ka zyrtarizuar se ka fituar të drejtat e transmetimit ekskluziv të tri ligave më të forta evropiane të UEFA-së: Champions League, Europe League dhe garën më të re e cila do ta ketë premierën e saj pikërisht vitin e ardhshëm, Conference League



**Prishtinë, 10 qershor** - Nga viti i ardhshëm 2021 e deri më 2024, për tri sezone rresht, "Armtmotion" do të jetë adresa e vetme dhe ekskluzive e programit më ekskluziv në botën e futbollit, UEFA Champions League, kupës së dytë më të rëndësishme të futbollit evropian Europe League dhe Conference League e cila do të jetë niveli i tretë i garave të klubeve të futbollit në Kontinentin e Vjetër dhe e cila do të debutojë pikërisht me "Armtmotion". "Përveç

transmetimeve ekskluzive të tri garave më prestigjioze të futbollit në Botë, nga viti 2021 deri më 2024, në një bashkëpunim ekskluziv dhe për herë të parë në Kosovë, 'Klan Kosova' dhe 'Armtmotion' do të sjellin emisionin special kushtuar këtyre garave, emision ky i cili do të emitohet çdo javë dhe do të ketë përmbajtje ekskluzive të garave e, po ashtu, edhe magazinën javore të UEFA-s". "Armtmotion" në filllet e saj ka bërë atë që asnjë medium tjetër

shqiptar nuk e ka bërë kurrë më parë në histori, ka siguruar të drejtat ekskluzive të transmetimit të gjitha garave më të mëdha botërore të xhudos ku abonuesit e 'Armtmotion' kanë pasur mundësi t'i shohin sukseset e Majlinda Kelmendit, Nora Gjakovës, Distrie Krasniqit e Akil Gjakovës dhe gjithë e xhudistëve tanë. Duke i falënderuar vizionit dhe projektit të Art Sportit në 'Armtmotion', ju kemi sjell të gjitha betejat për medalje dhe pikë

olimpike, gjë të cilën, po ashtu, kurrë asnjë medium shqiptar nuk e ka bërë".

Nuk kanë kaluar më shumë se dy vjet prej se "Armtmotion" e ka filluar revolucionin në programet sportive kosovare, në veçanti "Armtmotion" ka merita të mëdha për rikthimin e shkëlqimit të basketbollit të Kosovës pasi ka nënshkruar kontratë ekskluzive me Federatën e Basketbollit të Kosovës për të transmetuar mbi 230 ndeshjeve në vit, të gjitha ligave: Superligës, Ligës 1, Superligës së femrave dhe grupmoshave të reja, po ashtu garave të Superkupave, Kupave, ndeshjet e FIBA Champions League të dhe FIBA Europe Cup dhe natyrisht, ndeshjet e gjitha reprezentacioneve. Me sigurimin

e të drejtave ekskluzive për transmetimin e UEFA Champions League, Europe dhe Conference League, "Armtmotion" është shndërruar në platformën televizive shqiptare me programin sportiv më të pasur, më të llojlojshëm, më atraktiv dhe më ekskluziv në Kosovë dhe më gjerë sepse ka edhe ekskluzivitetin e transmetimit të qindra e mijëra ngjarjeve nga dhjetëra e dhjetëra sporte si: Formula 1 e Moto GP, pastaj sporteve luftarake si ONE CHAMPIONSHIP (gara më e shikuar në botë e arteve të përziera parcale), ENFUSION dhe natyrisht, ekskluzivisht në "Armtmotion" mund t'i shikoni të gjitha meçet e boksierit kosovar Robin Krasniqit. "Ky është vetëm fillimi!"

## KOK-u dhe UP-ja do t'i mbjellin 200 pemë

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm Shasivar Haxhijaj, kanë pritur të mërkurën drejtuesit e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP), rektorin Marjan Dema dhe prorektorin Myrvete

Badivuku. Presidenti Hasani, duke falënderuar rektorin Dema dhe prorektorin Badivuku për vizitën, ka theksuar se KOK-u prej vitesh ka bashkëpunim të frytshëm me UP-në dhe ky bashkëpunim është thelluar edhe javën e kaluar, me rastin e shënimit të 5 qershorit - Ditën

Botërore të Ambientit dhe Sportit, ku komunat e Kosovës mbollën nga një pemë në kompleksin e UP-së. "Të dyja palët u pajtuan që të mbjellin edhe 200 pemë të tjera në këtë kompleks, të cilat do të mbillen gjatë dy muajve të ardhshëm dhe që lidhen më 23 qershorin - Ditën Olimpikë, me shtyrjen e

Lojërave Olimpikë 'Tokio 2020', si dhe aktivitete të tjera, të cilat, shkak i pandemisë Covid-19, nuk do të mbahen sipas plan-programit të paraparë", thuhet në njoftimin e KOK-u. Rektori Dema përgëzoi drejtuesit e KOK-ut për punën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, duke ofruar mbështetjen e plotë



të UP-së, për çka ka thënë se edhe institucioni që drejtojnë mbështet kujdesin për një ambient të pastër. Të dyja palët në shenjë respekti për njëra-tjetrën shkëmbyen dhurata modeste.

## Emini: Drita, kundërshtare e vështirë, por ne kemi dy përparësi

**MITROVICË, 10 QERSHOR** - Skuadra e Trepçës '89 ndeshjen e radhës e zhvillon kundër Dritës, e cila është kryesuese në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Futbollisti Leart Emini ka thënë se skuadra

e '89-shit e ka përparësi terrenin vendës, por edhe disa kundërshtarë që do të mungojnë në lojë. "Drita ka skuadër shumë të pjekur dhe cilësore me lojtarë të shquar dhe në këtë lojë vjen si lidere pas startit me

fitore. Në këtë takim pikët janë të rëndësishme për dy ekipet, por ne do të përpiqemi ta shfrytëzojmë përparësinë e terrenit vendës dhe disa mangësi të kundërshtarit për ta fituar ndeshjen. Ne jemi në

zonën e kuqe dhe çdo hap fals, sidomos në ndeshjet si vendëse, do të jetë vështirë i rikuperueshëm për faktin se gara do të jetë e nxehtë deri në fund të kampionatit", ka thënë Emini.



## FIBA i asiston FBK-së për hartimin e planit pesëvjeçar

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku, të mërkurën kanë pasur takim (nëpërmjet video-konferencës) me përfaqësues të FIBA-s dhe FIBA Europe. Tema e këtij takimi ishte procesi i asistimit të FIBA-s në hartimin e Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025. Në takimin paraprak që ishte në muajin maj ka qenë FIBA ajo që e ka zyrtarizuar asistencën për FBK-në në hartimin e planit strategjik të FBK-së, duke e prezantuar edhe ekspertin e jashtëm të angazhuar nga FIBA për të asistuar FBK-në. FIBA dhe FIBA Europe kanë prezantuar ekipin e udhëhequr nga eksperti i jashtëm Geoff Wilson që do ta asistojë FBK-në në këtë rrugëtim shumë të rëndësishëm për zhvillimin e basketbollit të Kosovës.

Pas takimit kryetari i FBK-së, Fetahu, është shprehur shumë i kënaqur me rrjedhën e takimit dhe me përkushtimin e FIBA-s për ta asistuar FBK-në në këtë projekt shumë të rëndësishëm për komunitetin e basketbollit në vendin tonë. "FIBA dhe FIBA Europe e kanë të qartë se FBK, pavarësisht se është anëtarësuar më 2015 në FIBA, ajo për 5 vjet është rritur shumë në çdo aspekt dhe për këtë gjë, kemi marrë lëvdata të mëdha nga zyrtarë të FIBA-s dhe FIBA Europe që ishin



të pranishëm në këtë takim", ka thënë Fetahu. "Megjithatë, kur e kemi bërë kërkesën në FIBA për të na asistuar në hartimin e planit strategjik, ne e kemi bërë të qartë se jemi të vetëdijshëm se jemi zhvilluar shumë si Federatë, por tani duam që të rritemi edhe më shumë dhe të bëjmë më të mirën për komunitetin e basketbollit në vendin tonë. Është më se e qartë se për t'i arritur të gjitha këto objektiva na duhet një plan afatgjatë siç është planifikimi strategjik pesëvjeçar. Jemi shumë të lumtur që e kemi nisur këtë proces dhe se në të ardhmen e afërt do të mund t'u ofrojmë shumë më shumë grupeve tona të interesit", ka deklaruar Fetahu.

Ndërsa sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, e cila njëherësh do të

jetë edhe projekt-menaxhere e këtij projekti, ka thënë se hartimi i planit strategjik do të jetë një proces shumë i mirëseardhur për FBK-në. "Në bashkëpunim me FIBA-n në procesin e hartimit të planifikimit strategjik do t'i përfshijmë të gjitha grupet tona të interesit, do të dëgjojmë lëvdata e kritika, por të gjitha këto do të na ofrojnë një pasqyrë më të qartë të gjendjes në basketbollin tonë dhe më pas do të punojmë në objektivat tona strategjike, planet e veprimit dhe ato të kontrollit. Ne jemi shumë të kënaqur me asistencën që na ka ofruar FIBA me ekspertët ndër më të mirët të këtij lëmi në fushën e sportit dhe besojmë se deri në fund të vitit do t'i ofrojmë komunitetit tonë një plan strategjik që do të jetë i mirëseardhur për të gjithë", ka deklaruar Dushku.

## Anulohen të gjitha garat për grupmoshat e reja

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë Covid-19, në bazë të kompetencave të veta statutare më 10 qershor 2020, ka marrë vendim që t'i anulohet garat në të gjitha grupmoshat e reja për edicionin 2019/2020 dhe me këtë rast nuk do të shpallen kampionët e këtyre kompeticioneve. "Vendimet për ndërprerjen dhe më pas anulimin e garave në të gjitha kategoritë, përfshirë këtu edhe vendimet e datës 31 mars dhe 19 maj 2020, janë marrë duke pasur në vëmendje dhe radhë të parë shëndetin e basketbollistëve/eve, trajnerëve, punëtorëve sportivë dhe të gjithë aktorëve të



përfshirë në organizimin e garave të basketbollit, si dhe karakteristikat e sportit tonë, zhvillimi i të cilit është i pamundur në kohë kur pandemia globale po vazhdon që

të jetë e pranishme në Kosovë", thuhet në njoftimin e FBK-së. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

### SHKURT

#### Haxhimusa vazhdon kontratën me Dritën

Skuadra e Dritës vazhdon t'i vazhdojë kontratat me futbollistët aktualë. Klubi nga Gjilani ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës edhe me sulmuesin Betim Haxhimusa. "Klubi ynë ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës me Betim Haxhimusen edhe për dy vjetet e ardhshëm. Betimi do të jetë me ne deri në vitin 2022. Drejtori sportiv Valon Zymberi pas marrëveshjes tha se Betimi ka qenë gjithmonë një lojtar i rëndësishëm për ne dhe se është i lumtur që do të jetë edhe për dy vjetet e ardhshëm me ne", thuhet në njoftimin e Dritës.

#### Cana, kandidat për drejtor sportiv të Lozanës

Ish-kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, mund të marrë një post të rëndësishëm në futboll. Sipas medias zvicerane "Le Matin", Cana mund të emërohet drejtor sportiv i Klubit të Lozanës. Me largimin e Pablo Iglesiasit nga kjo detyrë javën e kaluar, futbollisti me më shumë ndeshje në historinë e kombëtares së Shqipërisë shihet si kandidati kryesor për ta marrë detyrën e drejtorit sportiv në klubin që kryeson kategorinë e dytë të futbollit në Zvicër. Pas tërheqjes nga futbollit në vitin 2016, Cana është licencuar si trajner, ndërkohë drejton dhe fondacionin "Lorik Cana 5".

#### Federeri operohet sërish, mungon deri në vitin 2021

Viti 2020 përfundon para kohe për Roger Federerin. Tenistit zviceran, në fakt, iu desh t'i nënshtrohej një operacioni në gju, në të njëjtin vend ku ishte operuar disa muaj më parë. Lajmin e shpërndau vetë kampioni 38-vjeçar i tenisit në rrjetet sociale. "Disa javë më parë unë pata një dëmtim të vogël gjatë rehabilitimit tim. Ishte e nevojshme të bëj një ndërhyrje të re të shpejtë në gjurin e djathtë. Do të më marrë malli shumë për tifozët dhe turneun tim të dashur. Po pres me padurim që t'ju shoh përsëri në fillim të sezonit 2021. Do ta marrë kohën e nevojshme që të jem 100 % gati për të luajtur në nivelin tim më të lartë", ka thënë Federeri.

#### FIFA: S'ka transferime pa përfunduar sezoni

FIFA ka shprehur mendimin e saj për problemin shumë të nxehtë të kontratave që skadojnë më 30 qershor. Ideja e institucionit më të rëndësishëm të futbollit në botë është që lojtarët të mos lejohen që të ndryshojnë skuadrat para se të përfundojë sezoni, duke shtrirë në mënyrë efektive kohëzgjatjen e kontratave. Për ta bërë këtë, FIFA dëshiron të vendosë një datë të përbashkët për fillimin e transferimeve. E lehtë për t'u thënë, por e vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Para se gjithash, ekziston problemi i vullnetit të lojtarëve, të cilët, me skadimin e 30 qershorit, kanë të drejtë të çlirohen nga kontratat. Të njëjtën gjë duan edhe shumë klube, që nuk kanë ndërmend të zgjasin, madje edhe për disa muaj, kontratën e disa prej punonjësve të tyre. E vetmja siguri është nevoja për të gjetur një marrëveshje sa më shpejt të jetë e mundur sepse koha po skadon.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada-Government*  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, General Hospital  
"Dr. Sami Haxhibeqiri"- Mitrovicë/a

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës /Nr. 03/L-212/ si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ /MPMS/ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të MPMS, u.d. drejtori Ekzekutiv i Spitalit të Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë, mori vendim dhe shpallë:

### KONKURS PUBLIK

**Institucioni:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Titulli i vendit të punës:** Mjek Specialist – Oftalmolog / dy (2) pozita/  
**Vendi i Punës:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Kategoria funksionale/Grada:** koeficienti i pagës / 8.40 /  
**Kontrata e punës:** Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/  
**Detyrat dhe përgjegjësitë:** konform përshkrimit të vendit të punës të Spitalit të Përgjithshëm - Mitrovicë.

**Institucioni:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Titulli i vendit të punës:** Mjek Specialist – Neurolog / një (1) pozitë/  
**Vendi i Punës:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Kategoria funksionale/Grada:** koeficienti i pagës / 8.40 /  
**Kontrata e punës:** Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/  
**Detyrat dhe përgjegjësitë:** konform përshkrimit të vendit të punës të Spitalit të Përgjithshëm - Mitrovicë.

**Institucioni:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Titulli i vendit të punës:** Mjek Specialist – Pediatër / një (1) pozitë/  
**Vendi i Punës:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Kategoria funksionale/Grada:** koeficienti i pagës / 8.40 /  
**Kontrata e punës:** Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/  
**Detyrat dhe përgjegjësitë:** konform përshkrimit të vendit të punës të Spitalit të Përgjithshëm - Mitrovicë.

**Institucioni:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Titulli i vendit të punës:** Mjek Specialist – Gjinekologji me Obstetrikë / një (1) pozitë/  
**Vendi i Punës:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Kategoria funksionale/Grada:** koeficienti i pagës / 8.40 /  
**Kontrata e punës:** Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/  
**Detyrat dhe përgjegjësitë:** konform përshkrimit të vendit të punës të Spitalit të Përgjithshëm - Mitrovicë.

**Institucioni:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Titulli i vendit të punës:** Mjek Specialist – Mjekësi Emergjente / një (1) pozitë/  
**Vendi i Punës:** Spitali i Përgjithshëm "Dr. " Sami Haxhibeqiri" - Mitrovicë  
**Kategoria funksionale/Grada:** koeficienti i pagës / 8.40 /  
**Kontrata e punës:** Në kohë të pacaktuar /sipas Ligjit të Punës/  
**Detyrat dhe përgjegjësitë:** konform përshkrimit të vendit të punës të Spitalit të Përgjithshëm - Mitrovicë.

**Shkollimi i kërkuar për pozitën mjek specialist:** Të kenë arsimim universitar, specialist i lëmisë së kërkuar.  
**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen për pozitën mjek specialist:** Të kenë të mbaruar Fakultetin e Mjekësisë dhe specializimin adekuat të lëmisë përkatëse. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë notën mesatare më të lartë gjatë studimeve themelore, njihjen e gjuhës angleze dhe që kanë trajnime të veçanta në fusha profesionale, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës; Të kenë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të kenë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim, njihja e punës me kompjuter është e domosdoshme.  
**Dokumentet e kërkuara për pozitën mjek specialist:** Diploma e Fakultetit, Çertifikata e specializimit, Licenca e Punës valide e Mjekut Specialist nga Institucioni kompetent i Republikës së Kosovës, kopje të letërnjoftimit si dhe çdo dokument apo certifikatë trajnime që kandidati e vlerëson si përparësi në përgatitje të tij. Dokumentet e kërkuara të dorëzohen në kopje, originalin e këtyre dokumenteve ose të vertetuara në noteri do të kërkohe vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë veprimi, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësitë e kërkuara profesionale për kryerjen e detyrave.

**"Spitali i Përgjithshëm – Mitrovicë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".**

**"Komunitetet jo shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional".**

**Procedurat e konkurimit:** Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:** Procedurat e rekrutimit rregullohen sipas Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës / Nr. 03/L-212/ si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ /MPMS/ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të MPMS.

**Data e mbylljes së konkursit:** 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen dhe kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen.

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Arkivës në Spitalin e Përgjithshëm „Dr. Sami Haxhibeqiri” – Mitrovicë, Lagja Bair - 40.000, Mitrovicë. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës.

Kontaktet me telefon mund ti bëni në 028-530-811.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada-Government*  
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, General Hospital "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovicë

Na osnovu clana 8. Zakona o radu Republike Kosova/br. 03/L-212/, Administrativnog Uputstvo /MRSZ/ br. 07/2017 za regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, izvršni direktor Opšte Bolnice "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovica, doneo je odluku o raspisivanju:

### JAVNOG KONKURSA

**Institucija:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri: Mitrovica  
**Naziv radnog mesta:** Lekar specijalista - Oftalmologija /dve (2) pozicije/  
**Radno mesto:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovica  
**Funksionalna kategorija/stepen:** Koeficient LD /8.40/  
**Ugovor o radu:** Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/  
**Zadaci i odgovornosti:** na osnovu zadatka na osnovu radnog mesta.

**Institucija:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri: Mitrovica  
**Naziv radnog mesta:** Lekar specijalista - Neurologija /jedna (1) pozicija/  
**Radno mesto:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovica  
**Funksionalna kategorija/stepen:** Koeficient LD /8.40/  
**Ugovor o radu:** Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/  
**Zadaci i odgovornosti:** na osnovu zadatka na osnovu radnog mesta.

**Institucija:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri: Mitrovica  
**Naziv radnog mesta:** Lekar specijalista - Pedijatrije /jedna (1) pozicija/  
**Radno mesto:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovica  
**Funksionalna kategorija/stepen:** Koeficient LD /8.40/  
**Ugovor o radu:** Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/  
**Zadaci i odgovornosti:** na osnovu zadatka na osnovu radnog mesta.

**Institucija:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri: Mitrovica  
**Naziv radnog mesta:** Lekar specijalista – Akušersko i Ginekologija /jedna (1) pozicija/  
**Radno mesto:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovica  
**Funksionalna kategorija/stepen:** Koeficient LD /8.40/  
**Ugovor o radu:** Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/  
**Zadaci i odgovornosti:** na osnovu zadatka na osnovu radnog mesta.

**Institucija:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri: Mitrovica  
**Naziv radnog mesta:** Lekar specijalista za Urgentnu Medicinu /jedna (1) pozicija/  
**Radno mesto:** Opšta Bolnica "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovica  
**Funksionalna kategorija/stepen:** Koeficient LD /8.40/  
**Ugovor o radu:** Na neodredjeno vreme/na osnovu Zakona o Radu/  
**Zadaci i odgovornosti:** na osnovu zadatka na osnovu radnog mesta.

**Potrebno školovanje za lekara specijalista:**Univerzitetska stručna sprema, specijalista odgovarajuće oblasti.

**Sposobnosti/iskustvo i ostali atributi za lekare specijalista:** Kandidati treba da imaju završen medicinski fakultet, specijalizaciju odgovarajuće oblasti. Prednost će imati kandidati koji u toku studija imaju veću prosečnu ocenu, poznavanje engleskog jezika, koji imaju posebne stručne obuke, dobro poznavanje funkcionisanja Zdravstvenog Sistema Kosova. Da imaju dokazane sposobnosti za efektivnu komunikaciju na pismenom i govornom aspektu, da imaju znanja službenih jezika na upotrebi, znanje za upotrebu kompjutera je obavezna.

**Potrebna dokumentacija za radno mesto lekara specijalista:** Diploma fakulteta, Uverenje o specijalizaciji, licenca rada lekara specijalista od odgovorna institucija Republike Kosova, fotokopije lične karte, kao i druga dokumentacija ili uverenja o stručnom usavršavanju koji kandidat smatra za prednost svoje stručne spreme. Tražena dokumentacija dostavlja se kopirana, originalna i overena dokumentacija kod notera tražiće se samo kada se vrši prijem kandidata u radni odnos.

**"Opšta Bolnica – Mitrovica pruža jednake mogućnosti zaposljavanja svim državljanima Kosova i rado prima prijave za zaposljavanje od svi lica muskog i zenskog pola iz svih zajednica na Kosovu".**

**"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu proporcionalno predstavljeni na sektoru zaposljavanja"**

**Postupak konkurisanja:** Konkurisanje je javno za sve zainteresovane kandidate.

**Zakonski i podzakonski propisi koji uređuju konkurisanje:** Postupak rekrutacije propisano je Zakonom o Radu Republike Kosova, /br. 03L 2012./, Administrativnog Uputstvo /MRSZ/ br. 07/2017 za regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru.

**Datum zatvaranja konkursa:** 15 dana od dana oglašavanja. Zahtevi dostavljeni nakon isteka roka neće se primiti kao i nekompletna dokumentacija neće se razmatrati. Zbog velikog broja dostavljenih zahteva, samo kandidati izabrani na listu užeg izbora će se kontaktirati.

**Dostavljanje zahteva:** Aplikacije uzimaju se i dostavljaju se u Kancelariji Pisarnice Opšte Bolnice "Dr. Sami Haxhibeqiri" Mitrovica, Naselje "Bair" 40.000 Mitrovica.

Na aplikaciji treba jasno da se naznači naziv radnog mesta. Kandidati mogu da kontaktiraju na tel: 028/530/811.

REPUBLIKA E KOSOVË  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Njoftimi për shprehje të interesit  
Emri i shkollës: "Emin Duraku"  
Komuna: Lipjan  
Data: 11.06.2020

Pranuar më: Primjeto:	10.06.2020	
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
4-400	22736	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/023-G/1.1	Blerje e mjeteve te teknologjisë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Emin Duraku", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Laptop 2 Copë
  - Projektor me mbajtës statik 2 Copë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Emin Duraku" Lipjan, më së largu deri më 19.06.2020
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues:  
Hazbi Sahiti  
Telefoni: 044 183-336  
E-maili: hazbi.sahiti@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVË  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Njoftimi për shprehje të interesit  
Emri i shkollës: "Vilëzërit Frashëri"  
Komuna: Lipjan  
Data: 11.06.2020

Pranuar më: Primjeto:	10.06.2020	
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
4-400	22743	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/025-G/1.1	Paisja me mjete të teknologjisë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Vilëzërit Frashëri", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Laptop 2 Copë
  - Projektor 1 Copë
  - Maus Wireles 3 Copë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Vilëzërit Frashëri" Lipjan, më së largu deri më 19.06.2020
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues:  
Avdi Azemi  
Telefoni: 049 852-692  
E-maili: avdzemi@gmail.com

REPUBLIKA E KOSOVË  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Njoftimi për shprehje të interesit  
Emri i shkollës: "Ismail Luma"  
Komuna: Lipjan  
Data: 11.06.2020

Pranuar më: Primjeto:	10.06.2020	
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
4-400	22744	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/024-G/1.3	Paisje teknologjike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Ismail Luma", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Laptop 2 Copë
  - Tastier Wireles 10 Copë
  - Maus Wireles 10 Copë
  - Kabell HDMI 10 Copë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Ismail Luma" Lipjan, më së largu deri më 19.06.2020
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues:  
Driton Sadiku  
Telefoni: 044 741-608  
E-maili: driton.sadiku@hotmail.com

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156    +386 49 848 553

PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE  
GLAVNI CENTAR PORODIÇNE MEDICINE  
AËLE HEKIMLIGË ANA MERKEZI

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prizren, në përputhje me Nenin 8, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 2.3 dhe 4, të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, nenin 15 pika 15.7 të Statutit të QKMF-së, si dhe Vendimit nr. 11/67 të datës 27.05.2020 të Këshillit Drejtues të QKMF-së, publikon;

**K O N K U R S**  
**Për praninë në marrëdhënie pune**

**Titulli i Vendit të Punës:**

**Doktor i Mjekësisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare - tetë (8) pozita**

**Kategoria dhe grada e punës:**

- Koeficienti: 7.20, H-27
- Orari: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-21
- Nr. i referencës; 12/1

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Pranon pacientin nga infermieri/ja, shënon të dhënat e duhura në kartelën shëndetësore. Merr anamnezën, bënë inspektimin, auskultimin dhe palpacionin e pacientit, bënë reanimimin kardiopulmonar, egzaminimin e shpinës dhe ekstremiteteve, referon pacientin për hulumtime të duhura. Cakton diagnozën, trajton pacientin me terapi adekuate, bënë edukimin dhe promovimin shëndetësorë, këshillojnë pacientin, cakton terminin e vizitës së ardhshme. Si dhe kryen të gjitha detyrat që parashihen me Rregulloren për Sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës për Doktorin e mjekësisë në QKMF.

**Kushtet e Konkursit:**

- Kandidatët që konkurrojnë për këtë vend pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të kenë të përfunduar:
- Fakultetin e Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm
- Të kenë Licencë Pune valide

**Dokumentet e kërkuara:**

- Aplikacioni i plotësuar
- Kopja e Diplomës së Fakultetit të mjekësisë
- Kopja e Licencës së punës
- Certifikata e lindjes (Ekstrakti i lindjes)

**Forma e aplikimit:**

Aplikimi duhet të bëhet vetëm në formë elektronike. Konkursi ngelet i hapur nga data 11.06.2020 - 25.06.2020 që konsiderohet si dita e fundit e konkursit. Aplikacionin mund ta plotësoni në linkun; [qkmf-prizren.org](http://qkmf-prizren.org) Dokumentacioni i cili nuk iu përgjigjet kërkesave dhe specifikave të Konkursit, si dhe dokumentacioni i pakompletuar dhe ai që merrin me vonesë, nuk do të shqyrtohen. Për pyetje dhe sqarim mund ta kontaktoni Zyrën e Personelit të QKMF-së, në numrin 029 230233.



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE  
GLAVNI CENTAR PORODIÇNE MEDICINE  
AËLE HEKIMLIGË ANA MERKEZI

Aile Hekimligë Ana Merkezi, 03/L-212 Iş Kanunu'nun 8. Maddesi uyarınca, Kamu Sektöründe İstihdam Sağlama Prosedürlerinin Düzenlenmesi İçin 07/2017 sayılı İdari Talimatının 2.3 ve 4. Maddesi, AHAM Tüzüğü'nün 15.maddesinin 15.7 bendine ve AHAM Yönetim Kurulunun 27.05.2020 tarihli 11/67 sayılı Karara uyarınca, mevcut iş yerlerinin doldurulması için:

**İŞ İLANI**

**İş Yeri Adı:**

**Aile Hekimligi Ana Merkezinde Tıp Doktoru - sekiz (8) iş yeri**

**Kategori ve iş yeri derecesi:**

- Katsayısı: 7.20, 11-27
- Mesai zamanı: haftada 40 saat
- Atama sğresi: Nr. 03/L-21 sayılı İş Kanunu uyarınca
- Ref. no: 12/1

**Görev ve sorumlulukları:**

Hastayı hemşireden kabul eder, uygun verileri sağlık kartına kaydeder. Anamnezi alır, hasta muayenesini, oskültasyonunu ve palpasyonunu yapar, kardiopulmoner reanimasyonunu yapar, sırt ve ekstremit muayenesini yapar, hastayı gerekli araştırma için yönlendirir. Teşhis koyar, hastayı uygun tedavi uygular, sağlık eğitimi ve teşviki gerçekleştirir, danışmanlık yapar, bir sonraki ziyaretin randevusunu belirler. Ayrıca AHAM Tıp Doktoru için İş ve İş Görevlerinin Sistemleştirilmesi Hakkında Yönetmenlikte öngörülen işleri gerçekleştirir.

**İş İlanı Koşulları:**

- Bu iş yeri için başvuran adaylar, kanunların öngördüğü genel koşullara ek olarak, aşağıdakileri de tamamlamaları gerekmektedir:
- Tıp Fakültesi – Genel bölüm
- Geçerli İş Lisansı

**Gereken evraklar:**

- Doldurulmuş başvuru formu
- Tıp Fakültesi Diploma kopyası
- Çalışma Lisansı Kopyası
- Doğum Belgesi (Doğum ekstraktı)

**Uygulama yöntemi:**

Başvuru sadece elektronik ortamda yapılmalıdır. İş ilanı tarihi 11.06.2020 son başvuru tarihi 25.06.2020. Başvuruyu bu linkten doldurabilirsiniz; [qkmf-prizren.org](http://qkmf-prizren.org) İş İlanı gerekliliklerini ve özelliklerini karşılamayan ve eksik veya yanı sıra gecikmeli olan belgeler dikkate alınmayacaktır. Soru ve açıklamalar için AHAM Personel Ofisi ile, 029 230233 numarasından iletişime geçebilirsiniz.

Personel ofis



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE  
GLAVNI CENTAR PORODIÇNE MEDICINE  
AËLE HEKIMLIGË ANA MERKEZI

Glavni centar porodične medicine u Prizrenu, u skladu s člankom 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, član 2,3 i 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o Uredbi postupaka za uspostavljanje radnih odnosa u javnom sektoru, član 15 tačka 15.7 Statuta MFMC, kao i Odluka br. 11/67 od 27.05.2020. Upravnog vijeća QKMF-a, objavljuje;

**K O N K U R S**  
**Za prijem u radni odnos**

**Naziv radnog mesta:**

**Doktor medicine u Glavnom centru porodične medicine - osam (8) radnih mjesta**

**Kategorija i stepen radnog mesta:**

- Koeficient: 7.20, H-27
- Radno vreme: 40 sati sedmično
- Trajanje imenovanja: Prema Zakonu o radu br.03/L-21
- Broj reference; 12/1

**Dužnosti i odgovornosti:**

Prihvata pacijenta od medicinske sestre, bilježi odgovarajuće podatke na zdravstvenoj kartici. Uzima anamnezu, vrši pregled, auskultaciju i palpaciju pacijenta, vrši kardiopulmonalnu reanimaciju, pregled leđa i ekstremiteta, upućuje pacijenta na odgovarajuće istraživanje. Određuje dijagnozu, liječi pacijenta adekvatnom terapijom, vrši edukaciju i promociju zdravlja, savjetuje pacijenta, određuje termin sljedeće posjete. Kao i obavlja sve zadatke predviđene Pravilnikom o sistematizaciji rada i radnih zadataka za doktora medicine pri GCPM.

**Uslovi Konkursa:**

- Kandidati koji se kandiduju za ovaj posao, uz opće uvjete utvrđene u Zakonu, moraju biti ispunjeni:
- Medicinski fakultet - Opšti menadžment
- Imati važeću radnu dozvolu

**Potrebna dokumenta:**

- Ispunjena aplikacija (prijava)
- Kopija diplome Medicinskog fakulteta
- Kopija radne dozvole
- Izvod iz matične knjige rođenih (izvod iz matične knjige rođenih)

**Nčin prijave:**

Prijava se mora izvršiti samo elektronskim putem. Datum objavljivanja Konkursa 11.06.2020 do, 25.06.2020. Aplikaciju možete popuniti na ovaj link; [qkmf-prizren.org](http://qkmf-prizren.org) Dokumentacija koja ne zadovoljava zahtjeve i specifičnosti Konkursa, kao i nepotpuna dokumentacija i ona koja kasni, neće se razmatrati. Za pitanja i pojašnjenja možete se obratiti Službi za kadrove GCPM na telefonskom broju 029 230233.

Kancelarija za Osoblje

**Lume's Details**  
**Estetik & Depilim**

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas  
Municipality  
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/250  
Më: 10/06/2020  
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2019/2020.

#### SHFMU "Restelica" Restelic

Mësimi në gjuhën boshnjake

1. Një mësimdhënës për Gjuhë Boshnjake

Mësimi në gjuhën shqipe

1. Një mësimdhënës për Gjuhë Shqipe

2. Një mësimdhënës për mësim klasor

3. Një mësimdhënës për Fizik (10 orë)

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Vërejtje:** Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë:10.06.2020  
Dragash

Drejtori i DKA-së  
MSc. Vloran Cenaj

Duke u bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, operatori i "BTP-Holding" Sh.P.K. Banjë, Vushtrri, impianti për prodhimin e vajrave motorike, industriale dhe përpunimin (riciklimin) e vajrave të përdorura mbeturinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 02.07.2020, në ora 11:00, në hapësirat e Kompanisë BTP HOLDING SH.P.K ne Banjë (Bajskë) rr.Hajzer Hasani ,Komuna e Vushtrrisë, do të organizohet debat publik nga operatori i "BTP-Holding" Sh.P.K. Banjë, Vushtrri, impianti për prodhimin e vajrave motorike, industriale dhe përpunimin (riciklimin) e vajrave të përdorura mbeturinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Frukta-Fruta Transport Doool" Dega në Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71284727.

► Albena Asllan Shala shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Anton Çeta" Skenderaj.

► Ibadete Ramadani shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së nëntë në shkollën "Asim Vokshi".

► Që nga data 04.05.2020, "MBC" me seli në Vushtrri bënë njoftimin për zvogëlim të kapitalit themeltar të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO  
Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash  
Drejtoria Komunale për Arsim - Direktorijati za Obrazovanje

Br.13/250  
Dana: 10.06.2020  
Dragaš,

Na osnovu Zakona o Preduniverzitetskom Obrazovanju Republike Kosova br. 04/L-032, člana 8 Zakona o Rađu Republike Kosova br. 03/L-212, člana 5 Zakona o Obrazovanju u Opštinama Republike Kosova br.03/L-068, Administrativno Uputstvo (MONT) br.10/2018 od 20.07.2018 o normativu o stručnom osoblju opšteg obrazovanja, Administrativnog Uputstva br.05/2015 normativi za nastavnike stručnog obrazovanja, Administrativnog Uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura konkurisanja u Javnom sektoru, Odluke MONT-a br.232/01B, Odluke MONT-a br.231/01B od dana 04.08.2015, zahteva MONT-a ref.2-2955 od dana 01.07.2016, Direktorijati za Obrazovanje u Dragašu objavljuje:

### KONKURS

Za popunjavanje slobodnih mesta za predškolsko, niže srednje osnovno obrazovanje Opštine Dragaš za školsku 2019 i 2020 godinu.

#### ONŠŠ "Restelica" u Restelici

Nastava na Bosanskom jeziku  
- Jedan nastavnik Bosanskog Jezika  
Nastava na Albanskom jeziku  
- Jedan nastavnik za Albanski Jezik  
- Jedan nastavnik razredne nastave  
- Jedan nastavnik Fizike (10 časova)

#### I. Sa aplikacijom se prilažu sledeća dokumenta:

- Formulari za konkurisanje koji se dobijaju pri Direktorijatu Obrazovanja, gde se i predaju za ostalom popratnom dokumentacijom.
- Lični dokumenat (kopija lične karte ili pasoša)
- Diploma mora biti overena, u protivnom se neće smatrati validnom (ili certifikat), certifikati moraju da budu overeni kod notera i ne stariji od 6 meseca.
- Kandidati koji su diplomirali van Republike Kosova, trebaju dostaviti nostrifikovanu diplomu.
- Potvrda da kandidat nije pod istragom, i potvrda o radnom iskustvu u obrazovanju (ako poseduje)

Konkurs je otvoren **15 dana**, od dana objavljivanja u sredstvima informisanja.

**Napomena:** Dokumentacija za konkurisanje se ne vraća kandidatima.

Dana: 10.06.2020,  
Dragaš

Direktor DO-a  
MSc. Vloran Cenaj



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

